# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5918
E enjte, 31 tetor 2019
çmimi 0.40 €


## Gjykata Supreme vendos të numërohen 4 639 votat e diasporës

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", TOMË GASHI FAQE 4-5



# Prokuroria Speciale duhet ta zbardhë vdekjen e Astrit Deharit

## - Vdekja e Astritit është vrasje e natyrës politike

Avokati i familjes së të ndjerit Astrit Dehari, Tomë Gashi, ka mirëpritur vendimin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, që rasti i vrasjes së Astrit Deharit të kalojë nga Prokuroria Themelore në Prizren nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se Prokuroria në Prizren ka qenë e njëanshme dhe, si e tillë, ka humbur kredibilitetin që të merret me këtë rast. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka thënë se Prokuroria Speciale ka kapacitete për ta zbardhur të vërtetën për vdekjen e Astritit. Sipas tij, prokuroria e shtetit mund të angazhojë edhe prokurorë amerikanë në mënyrë që vrasësit e Astrit Deharit të dalin para drejtësisë. Gashi ka ritheksuar se është ditur fare mirë se vrasja e Astritit është vrasje e natyrës politike. Ai ka thënë se drejtësia e dërguar në vend do të jetë drejtësi për Astritin

## OPINION

### SHTEGU I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR F. 8

Prof. Asoc. Dr. Arben DËRMAKU



### RRUGËTIMI I KOSOVËS, DREJT STABILIZIMIT APO DREJT SHPËRBËRJES! F. 12

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE

### ZEKA: MPB-JA KA ZBATUAR ME SUKSES FUSHATËN PËR LEGALIZIMIN E ARMËVE F. 9

## EKONOMI

### ANP 'ADEM JASHARI', STORIE E SUKSESIT NË AMADEUS IT CONFERENCE 2019 F. 9

### HAPET EDICIONI I KATËRT I FESTIVALIT TË GJELBËR F. 9



## SPORT

### MAQASTENA: PARAQITJE E MIRË E GJIMNASTËVE NË SLLOVENI F. 18

## Edita Tahiri, delegacionit serb: Kosova është dhe do të jetë përgjithmonë shtet



Republika e Kosovës është dhe do të jetë përgjithmonë shtet edhe pse nuk është pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), ka deklaruar të mërkurën ish-zëvendëskryeministra dhe ministrja për Dialog, Edita Tahiri, në takimin e OKB-së të nivelit qeveritar të shteteve Euro-Azi për shqyrtimin e barazisë gjinore 25 vjet pas Konferencës së Pekinit që po mbahet në Gjenevë. Reagimi i Tahirit ka ardhur pas kërkesës së delegacionit serb që Kosova të mos përmendet si shtet meqë nuk është pjesë e OKB-së FAQE 4



## Britania lanson projektin për forcimin e drejtësisë në Kosovë

FAQE 7


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Yuri Kim: Përpjekjet e Rusisë për ndikim në rajon nuk kanë pasur efekt

Yuri Kim, e emëruara për ambasadore të ShBA-së në Shqipëri, tha se "përpjekjet e Rusisë për ndikimin në rajon nuk kanë pasur shumë efekt dhe ka rëndësi që t'i ndihmojmë shqiptarët t'i forcojnë institucionet, në mënyrë që ata të jenë më rezistentë ndaj përpjekjeve të Rusisë si dhe depërtimit ekonomik të Kinës"




UASHINGTON, 30 TETOR - E emëruara për ambasadore të ShBA-së në Shqipëri, Yuri Kim, foli të martën pasdite në Uashington përpara Komisionit të Senatit për Punët e Jashtme në një seancë për konfirmimin e saj.
Kim, e cila u emërua nga presidenti Donald Trump në qershor të këtij viti, tha se nëse konfirmohet, do të ndiqte disa përparësi në punën e saj si ambasadore, ka njoftuar voa. Ajo tha se do ta inkurajonte Shqipërinë për ta arritur nivelin 2 për qind në shpenzimet e mbrojtjes deri në vitin 2024.
Diplomatja tha se do t'i nxiste udhëheqësit e vendit për ta zgjidhur ngërçin aktual politik në mënyrë që të forcohet perspektiva e hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE.
Kim shtoi se do të inkurajonte gjithashtu Shqipërinë t'i zbatonte plotësisht reformat në drejtësi, përfshirë kontrollin e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe krijimin e strukturave të posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ajo tha se sheh si përparësi edhe ndihmën teknike për Shqipërinë në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar ndërnacional.
Shqipëria, tha Kim në seancë, ka një emër jo të mirë për krimin e organizuar, për trafikimin e njerëzve, sidomos të grave si dhe të narkotikëve përmes kufijve.
Kimi tha se nëse konfirmohet, do të punonte gjithashtu për të nxitur eksportet dhe investimet amerikane në Shqipëri. Ajo tha se pak miq e kanë përqafuar Amerikën më ngrohtësisht sesa shqiptarët, sondazhe të shumta tregojnë se mbështetja shqiptare për Shtetet e Bashkuara mbetet ndër më të lartat në botë. Kim tha se ShBA-ja ka një mik të fortë dhe besnik te Shqipëria dhe se është e domosdoshme që të mbajë pranë miq të tillë. Pak partnerë janë më të gatshëm sesa Shqipëria që të bëjnë më shumë me Shtetet e Bashkuara, tha Kim.
Ajo tha se ushtarët shqiptarë kanë luftuar krah për krah me trupat amerikane në Afganistan dhe kanë shërbyer për këshillimin dhe trajnimin e forcave afgane krahas trupave të ShBA-së.
Shqipëria, tha Kim, ka qenë një partnere e besueshme në koalicionin global për të mposhtur ISIS-in dhe "ka treguar se jo vetëm vlerëson përfitimet nga anëtarësimi në NATO, por edhe përqafon përgjegjësitë që burojnë nga të qenit anëtare e aleancës".
Duke iu përgjigjur një pyetjeje të senatorëve për ndikimin e mundshëm të Rusisë në rajon, Kim tha se fatmirësisht, përpjekjet e Rusisë në këtë aspekt nuk kanë pasur shumë efekt. Për këtë arsye, tha Kim, "e kemi për detyrë që të mbajmë më afër miq të tillë si Shqipëria në kohë si kjo". Ka rëndësi, tha ajo, që t'i ndihmojmë shqiptarët të forcojnë institucionet, në mënyrë që ata të jenë më rezistentë ndaj përpjekjeve të Rusisë si dhe të depërtimit ekonomik të Kinës.
Nëse konfirmohet, Yuri Kim do të ishte gruaja e parë koreano-amerikane që përfaqëson ShBA-në në postin e një ambasadori, do të ishte gjithashtu personi i parë nga territori amerikan i Guamit që shërben në një post të tillë. Me Kushtetutë, ambasadorët emërohen nga presidenti dhe konfirmohen nga Senati.

# Shkupi refuzon ftesën ruse për anëtarësim në Bashkimin Ekonomik Euroaziatik



SHKUP, 30 TETOR - Maqedonia Veriore nuk është ftuar të anëtarësohet në Bashkimin Ekonomik Euroaziatik (EAEU), tha të mërkurën në Shkup kryeministri Zoran Zaev. "Ndoshta ka një lloj muri mbrojtës rreth kësaj qeverie, kështu që ne as nuk e morëm atë thirrje. Dhe kjo as nuk na vjen në mendje", tha Zaevi. "Nuk ka një ftesë të tillë, dhe shpresoj se nuk do të vijë", tha Zaevi, duke iu përgjigjur pyetjes së një gazetari nëse një ftesë për anëtarësim në EAEU kishte arritur pas fillimit të bisedimeve të anëtarësimit në BE. Nga Shqipëria ende nuk ka një përgjigje për ftesën ruse.
Ftesa u bë verbalisht nga përfaqësuesi i përhershëm i Rusisë në BE, Vladimir Chizhov, gjatë Forumit Ekonomik Eurasian në Verona të Italisë, të premten. "Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut do të gjejnë mirëkuptim më shpejt në EEU sesa në BE", theksoi diplomati rus.
Chizhov tha se "Unë jam i sigurt se vendet, të cilat janë kandidate për anëtarësim në BE dhe së fundmi janë" vënë në akull "nga Brukseli "mund të kenë më shumë benefite në EEU".
Ftesa e Rusisë për vendet e Ballkanit për t'u anëtarësuar në EUU vjen vetëm disa ditë pas një vendimi negativ nga presidenti Francez Emmanuel Macron.

## Integrimi i Shqipërisë dhe rajonit në BE, alternativë e vetme

TIRANË, 30 TETOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, është takuar me kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenkoviq, me te cilin ka diskutuar për çështjen e integrimit të shtetit shqiptar në Bashkim Evropian (BE).
Meta ka thënë se me kryeministrin kroat kanë ndarë qëndrimin e njëjtë se integrimi i Shqipërisë dhe rajonit në BE është alternativa e vetme.
Më tutje, Meta ka theksuar se marrja e Presidencës së Bashkimit Evropian (BE) për herë të parë nga Kroacia dhe qëndrimi i saj pro zgjerimit është mundësi e shtuar për Shqipërinë për çeljen e negociatave me BE-në. "Takim mjaft i frytshëm dhe konstruktiv me kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenkoviq, mbi marrëdhëniet e shkëlqyera tradicionale dhe politike mes dy vendeve tona. Ndamë të njëjtin qëndrim se integrimi evropian i Shqipërisë dhe rajonit, janë e vetmja alternativë e të ardhmes sonë të përbashkët. Marrja e Presidencës së BE-së për herë të parë nga Kroacia dhe qëndrimi i saj pro zgjerimit, mundësi e shtuar për Shqipërinë për çeljen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian gjatë samitit të Zagrebit në maj 2020. Bashkëpunimi ekonomiko-tregtar, do të marrë një shtysë të re me vendosjen e linjës direkte ajrore Tiranë-Zagreb dhe ndërtimin e gazsjellësit Adriatiko-Jonian IAP", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ish-zëvendëskryeministrja Edita Tahiri është duke marrë pjesë në takimin e OKB-së për barazinë gjinore 25 vjet pas Konferencës së Pekinit

# Edita Tahiri, delegacionit serb: Kosova është dhe do të jetë përgjithmonë shtet

Republika e Kosovës është dhe do të jetë përgjithmonë shtet edhe pse nuk është pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) ka deklaruar të mërkurën ish-zëvendëskryeministra dhe ministrja për Dialog, Edita Tahiri, në takimin e OKB-së të nivelit qeveritar të shteteve Euro-Azi për shqyrtimin e barazisë gjinore 25 vjet pas Konferencës së Pekinit që po mbahet në Gjenevë. Reagimi i Tahirit ka ardhur pas kërkesës së delegacionit serb që Kosova të mos përmendet si shtet meqë nuk është pjesë e OKB-së



EPOKA E RE Faton DERMAKU

**Prishtinë, 30 tetor** - Ish-zëvendëskryeministra dhe ministrja për Dialog, Edita Tahiri, është duke qëndruar në Gjenevë, ku po merr pjesë në takimin e OKB-së të nivelit qeveritar të shteteve Euro-Azi për shqyrtimin e barazisë gjinore 25 vjet pas Konferencës së Pekinit. Në takimin e së mërkurës ku është diskutuar për fuqizimin e grave, Tahiri ka polemizuar me delegacionin serb, duke ia bërë të qartë se Kosova është shtet edhe pse nuk është pjesë e OKB-së. "Unë jam në OKB në Gjenevë duke marrë pjesë në takimin e niveleve qeveritare të vendeve të Evropës dhe Azisë Qendrore që ka të bëjë me shqyrtimin e përparimeve dhe sfidave të barazisë gjinore që nga koha e Platformës së Pekinit, pra shqyrtimi 25-vjeçar i të arriturave dhe sfidave. Kosova nuk është e përfaqësuar meqenëse nuk është e përfaqësuar e OKB-së, por unë jam këtu e ftuar nga UN Women dhe kur u përmend Kosova në mesin e shteteve nga zyrtarë të caktuar që ishin në konferencë, pala serbe reagoi duke thënë se 'Kosova nuk duhet të përmendet si shtet meqë nuk është anëtare e OKB-së'. Pastaj në diskutimin tim që pata në lidhje me idetë për fuqizimin e grave, polemizova me palën serbe duke i thënë se Kosova është shtet dhe do të jetë përgjithmonë shtet ani pse ende nuk është anëtare e OKB-së", ka treguar Tahiri për gazetën "Epoka e re".

Para të pranishmëve Tahiri ka përmendur rastin e Zvicrës e cila ka qenë shtet edhe gjatë një kohe kur nuk ka qenë anëtare e OKB-së. Tahiri ka theksuar se të jesh apo mos të jesh pjesë e OKB-së nuk e konteston çështjen e shtetësisë. Ish-ministrja për dialog i ka bërë të qartë delegacionit serb se shteti i Kosovës është i njohur fuqishëm dhe është i vërtetuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. "Po ashtu, ia përmenda se Zvicra është shtet dhe ka qenë shtet edhe kur nuk ka qenë në OKB me vetëdëshirë. Kështu që të jesh apo mos të jesh pjesë e OKB-së nuk e konteston çështjen e shtetësisë. Po ashtu, ia bëra me dije se shteti i Kosovës është i njohur fuqishëm dhe është i vërtetuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND)", është shprehur Tahiri në forumin që po mbahet në Gjenevë.

Ajo ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ka qenë e rëndësishme që edhe një herë në një forum ndërkombëtar t'i bëhet e qartë Serbisë se Kosova është shtet dhe duhet ta pranojë këtë realitet. "Pra, ishte e rëndësishme që pala serbe, edhe në një forum të OKB-së ku ishin të gjitha shtetet pjesëmarrëse nga Euro-Azia, të dëgjojë se Kosova është shtet dhe se duhet ta pranojë realitetin e lindjeve të shteteve të reja dhe përfundimit të zhbërjes së ish-Jugosllavisë sepse ata ende janë me mentalitete hegjemoniste", ka deklaruar Tahiri.

# Britania lanson projektin për forcimin e drejtësisë në Kosovë

**Prishtinë, 30 tetor (ER)** - Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë ka lansuar të mërkurën projektin "Forcimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë". Ky projekt synon ta rrisë llogaridhënien, transparencën dhe integritetin, duke zhvilluar sisteme të qëndrueshme dhe në pronësi vendore, me fokus në proceset e rekrutimit, emërimit, avancimit dhe transferimit të të gjithë gjyqtarëve. Me këtë rast, ambasadori britanik Nicholas Abbott ka thënë se ky projekt dëshmon angazhimin e Britanisë për një sistem të pavarur të drejtësisë në Kosovë. "Lansimi i këtij projekti dëshmon edhe një herë angazhimin e Ambasadës së Britanisë së Madhe për të qenë partnere e ngushtë me sistemin e drejtësisë në Kosovë. Shteti im ka interes që ta mbështesë Kosovën në këtë rrugëtim. Kjo do të mundësonte që investitorët tanë të vijnë të investojnë në Kosovë", është shprehur ai.




Diplomati britanik ka thënë se për të pasur një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, transparent dhe llogaridhënës duhet të bëhen në mënyrën e duhur rekrutimet, emërimet e stafit udhëheqës dhe të kryetarëve të gjykatave si dhe vlerësimet e performancës. "Për të arritur deri te një sistem gjyqësor i pavarur, i paanshëm, transparent dhe llogaridhënës ne vlerësojmë që janë tri çështje kryesore që duhet të bëhen në mënyrën e duhur: rekrutimet; emërimet e stafit udhëheqës dhe të kryetarëve të gjykatave si dhe vlerësimet e performancës", ka deklaruar Abbott.

Ndërsa drejtori i projektit, Stive Pitts, ka treguar mënyrën se si do të realizohet ky projekt. "Gjatë katër muajve të parë të projektit tonë kemi mbledhur informacione dhe na është kërkuar të përqendrohemi në gjashtë fusha: emërimet, avancimet, vlerësimet e informacioneve, llogaridhënie dhe transparencë", ka theksuar ai.

Për lansimin e këtij projekti ka folur edhe kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), Skënder Çoçaj. Ai ka thënë se ky projekt do të sigurojë llogaridhënie dhe transparencë brenda sistemit gjyqësor. "Objektiv është aspekti i rekrutimit dhe fuqizimit sipas standardeve ndërkombëtare", ka deklaruar Çoçaj.

Flet për "Epokën e re", Tomë Gashi

# Prokuroria Speciale duhet ta zb

## - Vdekja e Astritit është vrasje e natyrës politike



Avokati i familjes së të ndjerit Astrit Dehari, Tomë Gashi, ka mirëpritur vendimin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, që rasti i vrasjes së Astrit Deharit të kalojë nga Prokuroria Themelore në Prizren nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se Prokuroria në Prizren ka qenë e njëanshme dhe, si e tillë, ka humbur kredibilitetin që të merret me këtë rast. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka thënë se Prokuroria Speciale ka kapacitete për ta zbardhur të vërtetën për vdekjen e Astritit. Sipas tij, prokuroria e shtetit mund të angazhojë edhe prokurorë amerikanë në mënyrë që vrasësit e Astrit Deharit të dalin para drejtësisë. Gashi ka ritheksuar se është ditur fare mirë se vrasja e Astritit është vrasje e natyrës politike. Ai ka thënë se drejtësia e dërguar në vend do të jetë drejtësi për Astritin

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 30 tetor** - Tomë Gashi, avokat i familjes së Astrit Deharit, e ka vlerësuar vendim të drejtë që rasti i vdekjes së Astrit Deharit të kalojë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka theksuar se Prokuroria në Prizren ka humbur kredibilitetin në këtë rast pasi, sipas tij, për tre vjet ka qenë e njëanshme për faktin se ish-kryeprokurori Sylë Hoxha ka dashur ta mbyllë rastin në mënyrë të kundërligjshme, kinse si vetëvrasje. "Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit kanë kapacitete t'i gjejnë vrasësit e Astrit Deharit dhe t'i akuzojnë ata", ka thënë Gashi.

Ai ka shtuar se vdekja e Astritit është vrasje e natyrës politike. "Ne besojmë se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka kapacitete të tilla që t'i identifikojë këta persona pasi të gjithë të përfshirit dihen me emra e mbiemra, së paku dihen se kush kanë qenë ata që e kanë hetuar rastin dhe kush kanë qenë ata për të cilët dihen që, thjesht, janë identifikuar si persona që kanë dashur ta mbyllin rastin si, kinse, vetëvrasje", është shprehur avokati Tomë Gashi.

Ai ka thënë se nuk janë kundër që Prokuroria e Shtetit të angazhojë edhe prokurorë të huaj, qoftë amerikanë, për këtë rast. "Ne mendojmë se Prokurori i Shtetit mund të kërkojë në të ardhmen edhe përfshirjen e prokurorëve amerikanë siç ka deklaruar ai në javën e kaluar dhe besojmë se nuk do të duhej të ishte ndonjë punë shumë e rëndë për identifikimin e asaj se kush ka qenë i përfshirë në rastin e vrasjes së Astrit Deharit dhe që të gjithë të dalin para drejtësisë", ka deklaruar Gashi, duke shtuar se drejtësia e dërguar në vend do të jetë drejtësi për Astritin.

**"Epoka e re":** *Z. Gashi, të mërkurën kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka marrë vendim që rasti i Astrit Deharit të kalojë nga Prokuroria Themelore në Prizren në juridiksion të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK). Si e komentoni këtë vendim?*

**Gashi:** Ky është një vendim i drejtë, i ligjshëm dhe në interes të drejtësisë që rasti i Astrit Deharit të merret nga Prokuroria në Prizren dhe të dërgohet në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, e cila lëndë, po ashtu, do të mbikëqyret nga një prokuror i shtetit që do ta caktojë Aleksandër Lumezi si Kryeprokuror i Shtetit. Prokuroria në Prizren ka humbur kredibilitetin që të merret me këtë rast dhe ajo prokurori që tre vjet ka qenë e njëanshme, posaçërisht ish-kryeprokurori Sylë Hoxha që ka dashtë ta mbyllë rastin në mënyrë të kundërligjshme, kinse si vetëvrasje, edhe pse ai e ka ditur fare mirë se rasti është pa asnjë dilemë vrasje, dhe vrasje e natyrës politike.

**"Epoka e re":** *Jeni optimist se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës do ta kryejë punën si duhet dhe do ta zbardhë të vërtetën për vdekjen e Astrit Dehari?*

**Gashi:** Sigurisht se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit kanë kapacitete t'i gjejnë vrasësit e Astrit Deharit dhe t'i akuzojnë ata, si dhe të identifikohen të gjithë ata që kanë marrë pjesë në çfarëdo mënyre në vrasjen/shtytjen për vrasje dhe në fshehjen e vrasjes për tre vjet. Ne besojmë se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka kapacitete të tilla që t'i identifikojë këta persona pasi të gjithë të përfshirit dihen me emra e mbiemra, së paku dihen se kush kanë qenë ata që e kanë hetuar rastin dhe kush kanë qenë ata për të cilët dihen se thjesht janë identifikuar si persona që kanë dashur ta mbyllin rastin si, kinse, vetëvrasje.

**"Epoka e re":** *Pas ekspertizës dhe raportit që keni marrë nga Instituti i Zvicrës, mendoni se në hetimet që do të bëhen për këtë çështje duhet të përfshihen edhe ekspertë amerikanë apo familja Dehari dhe ju si avokat do të*

# ardhë vdekjen e Astrit Deharit



*keni besim në Prokurorinë Speciale?*
**Gashi:** Ne nuk kemi asgjë kundër që Prokuroria e Shtetit të angazhojë prokurorë amerikanë në këto rrethana të krijuara dhe që ata të punojnë së bashku me prokurorë të shtetit të Kosovës që të akuzohen me prova vrasësit e Astrit Deharit. Pra, ne mendojmë se Prokurori i Shtetit mund ta kërkojë në të ardhmen edhe implikimin e prokurorëve amerikanë siç ka deklaruar ai në javën e kaluar dhe besojmë se nuk do të duhej të ishte ndonjë punë shumë e rëndë për identifikimin e asaj se kush ka qenë i përfshirë në rastin e vrasjes së Astrit Deharit dhe që të gjithë të dalin para drejtësisë. Duhet të hetohen edhe gardianët që kanë qenë aty, por edhe zyrtarët e policisë të regjionit të Prizrenit dhe hetuesit të cilëve më nuk u jepet mundësia ligjore që të punojnë fare në këtë rast për shkak se ata qëllimisht kanë dashur ta devijojnë rastin krejtësisht, duke pretenduar se kemi të bëjmë, kinse me vetëvrasje.

**"Epoka e re":** *Duke pasur parasysh se në Kosovë edhe pas dy dekadave shumë vdekje vazhdojnë të jenë enigmë, ka rrezik që edhe vdekja apo vrasja e Astrit Deharit të mbetet e tillë?*
**Gashi:** Ne besojmë se mund të ketë edhe raste të tjera siç është rasti i Astrit Deharit dhe për këtë duhet të japin përgjegjësi të gjithë ata që i dinë faktet dhe nuk flasin. Askush nuk do të duhet të vdiste në institucion shtetëror në vitin 2016, 17 vjet pas luftës dhe tetë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

**"Epoka e re":** *Cilët mendoni se duhet të jenë hapat që duhet të ndërmerren në mënyrë që e vërteta të triumfojë dhe sadopak të lehtësohet dhimbja e familjes Dehari?*
**Gashi:** E vërteta ka qenë e ditur që nga 5 nëntori i vitit 2016, se Astriti është vrarë në burg. Prandaj duhet që të hetohen dhe të akuzohen të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në rastin e vrasjes së Astrit Deharit. Po ashtu, kjo vlen edhe për ata që i kanë shtyrë vrasësit e Astritit dhe ata që e kanë fshehur vrasjen për tre vjet. Drejtësia e dërguar në vend do të jetë drejtësi për Astritin.



# Hetimet për vdekjen e Astrit Deharit kalojnë në Prokurorinë Speciale

**Prishtinë, 30 tetor (ER)** - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka marrë vendim që rasti i Astrit Dehari të kalojë nga Prokuroria Themelore në Prizren në juridiksion të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK). "Pas analizimit të prononcimeve në media të familjes së të ndjerit, Astrit Dehari, dhe përfaqësuesit të tyre ligjor, natyrës specifike dhe urgjente të këtij rasti, si dhe në funksion të zhvillimit me efikasitet të procedurës penale dhe evitimit të mëdyshjeve rreth mundësisë së shkeljes së parimit të paanshmërisë, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës caktohet ta bëjë trajtimin e mëtejshëm procedural të kësaj çështjeje penale", thuhet në njoftimin e Prokurorisë së Shtetit.
Po ashtu, në njoftim thuhet se bartësi i kësaj lënde autorizohet të kërkojë që i tërë rasti penal të bartet nga Departamenti i Hetimeve të Krimeve të Rënda në Prizren në Drejtorinë Qendrore të Policisë për Hetimin e Krimeve të Rënda në Prishtinë.
Më 24 tetor Prokuroria Themelore në Prizren ka publikuar konkluzionet e ekspertizës së Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e Astrit Deharit, i cili kishte vdekur më 5 nëntor 2016 teksa po mbahej në Qendrën e Paraburgimit në Prizren si i dyshuar për sulmin ndaj ndërtesës së Kuvendit, në gusht të vitit 2016. Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, Prokuroria tha se do ta vazhdojë hetimin e këtij rasti dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme.
Raporti i ekspertizës i është dorëzuar edhe familjes Dehari dhe avokatit Tomë Gashi. "Unë si prind tash pres nga organet e drejtësisë që të hapen hetimet dhe të kërkohet përgjegjësi për të gjitha ata që kanë marrë pjesë në vrasjen e Astritit", ka thënë babai i Astritit, Avni Dehari. Ndërkaq nëna e Astritit, Xhemile Dehari, ka thënë se e kanë ditur rastin që Astritin e kanë vrarë në burg.

# Pacolli merr pjesë në konferencën e ministrave të Organizatës së Frankofonisë

Prishtinë, 30 tetor (ER) - Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, po merr pjesë në Konferencën e 38 të ministrave të vendeve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë. Në margjinat e kësaj konference janë paraparë të zhvillohen edhe shumë takime bilaterale në mes të ministrave të jashtëm të hapësirës frankofone.
Kosova është anëtarësuar për herë të parë në Frankofoni si anëtare vëzhguese në vitin 2014, ndërsa në tetor të vitit të kaluar i është ngritur statusi në anëtar të asociuar. Që nga anëtarësimi i Kosovës si anëtare vëzhguese në vitin 2014 në Samitin e Frankofonisë në Dakar, Kosova ka bërë përpjekje të shumta për promovimin e gjuhës frënge dhe Frankofonisë.
Bashkëpunime të reja dhe të rëndësishme janë krijuar në nivel universitar, sidomos pas anëtarësimit të Universitetit të Prishtinës në Agjencinë Universitare Frankofone. Më tutje, Kuvendi i Kosovës i është bashkuar vitin e kaluar Asamblesë Parlamentare Frankofone, që do të kontribuojë për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet deputetëve kosovarë dhe deputetëve të vendeve të tjera frankofone në çështje të interesit të përbashkët për rajonin tonë, siç janë zhvillimi dhe promovimi i vlerave të demokracisë, paqes dhe diversitetit kulturor dhe linguistik.



## Shkolla "Asim Vokshi" në Malishevë do të bëhet me kabinet të informatikës

MALISHEVË, 30 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur të mërkurën në një takim pune ministrin në detyrë të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për themelimin e kabinetit të informatikës në Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët "Asim Vokshi" në Panorc.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, me këtë projekt përfshihet blerja e 25 kompjuterëve ("all in one"), 25 tavolinave për kompjuterë, 25 ulëseve dhe dy tabelave të mençura (smart), të cilat kapin një shumë prej 15 250 eurosh, që në tërësi do të financohet nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.



# Mbështetja e bizneseve të vogla, prioritet i Komunës së Gjakovës

GJAKOVË, 30 TETOR (ER) - Ndër prioritetet kryesore të Komunës së Gjakovës është krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet e vogla, në funksion të zhvillimit të tyre. Kështu është thënë të mërkurën në konferencën informuese e cila është mbajtur në kuadër të Ditëve të Biznesit të Vogël 2019. "Themelimi i Zyrës së AKB-së, investimet në infrastrukturë, rritja e subvencionimit të bizneseve nga viti në vit, janë disa prej elementeve të cilat janë mbështetje dhe lehtësim për funksionimin e bizneseve në Gjakovë. Kjo konferencë u organizua nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës, konkretisht Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik", ka njoftuar Komuna e Gjakovës. Sipas këtij njoftimi, bizneset pjesëmarrëse kanë shfaqur edhe vështirësitë që janë duke hasur gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre, të cilat është thënë se do të adresohen tek institucionet relevante.



# Ferizaj, asfaltohet rruga në Talinoc të Muhaxherëve

FERIZAJ, 30 TETOR (ER) - Komuna e Ferizajt ka njoftuar se është asfaltuar shtresa e parë e rrugës "Shabi Lipovica" në fshatin Talinoc i Muhaxherëve. Kjo komunë ka bërë me dije se rruga në fjalë pritet të krijojë lëvizje më të lehtë në mes të kësaj zone në afërsi të qytetit dhe rrugëve magjistrale që kryqëzojnë këtë lokalitet. Për t'i ndjekur punimet në këtë projekt, që kushton 850 mijë euro e që është me gjatësi prej tri kilometrash, ka dalë në vendngjarje drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, së bashku me mbikëqyrës e zyrtarë nga niveli lokal dhe Ministria e Infrastrukturës.



Me këtë rast, Bytyqi ka thënë se kjo rrugë paraqet një rëndësi të jashtëzakonshme për banorët dhe bizneset në këtë zonë, duke përmirësuar cilësinë e jetës dhe kushtet e zhvillimit të veprimtarisë biznesore. "Ndodhemi në rrugën 'Shabi Lipovica', ku po bëjmë asfaltimin e shtresës së parë. Është një projekt në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, një projekt që po ndikon në rritjen e cilësisë së banorëve të kësaj zone pasi, siç e dini, deri më tash ka qenë shumë i vështirë qarkullimi në këtë zonë dhe ky projekt po ndikon që, përveç cilësisë së jetës së banorëve, edhe në bizneset dhe normalisht pas përfundimit të asfaltimit, qarkullimi përmes kësaj rruge do të jetë më i lehtë. Bëhet fjalë për një projekt në vlerë rreth 850 mijë euro, me gjatësi tri kilometra. Një pjesë e segmentit që është e banuar dhe ka shtrirje të biznesit do të ketë edhe trotuar", ka thënë Bytyqi.

# Nis ndërtimi i rrjetit sekondar të kanalizimit në dy lagje të Junikut

JUNIK, 30 TETOR (ER) - Komuna e Junikut ka njoftuar se kanë filluar punimet për ndërtimin e rrjetit sekondar të kanalizimit për ujërat e zeza në dy lagje të kësaj komune. Në njoftimin për medie kjo komunë ka bërë me dije se bëhet fjalë për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në lagjen Miroc dhe Malok. "Komuna e Junikut ka filluar punimet për ndërtimin e rrjetit sekondar të kanalizimit në lagjen Miroc dhe Malok në kuadër të iniciativës 'Shërbime të mira për Junikun e pastër dhe ekologjik'. Projekti financohet nga Komuna e Junikut", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Junikut.




## KFOR-i italian i dhuron Gjakovës dy karrige stomatologjike

Gjakovë, 30 tetor (ER) - KFOR-i italian ka dhuruar donacion dy karrige stomatologjike në Gjakovë të cilat do të jenë në funksion të një preventive më të mirë dentare. Një donacion i tillë është dorëzuar nga komandanti i KFOR-it italian, kolonel Daniele Pisani, i cili është shprehur se rikthimi në Gjakovë, pas tetëmbëdhjetë vjetësh nga misioni i parë, është një ndryshim i madh. Ndërsa kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, ka falënderuar KFOR-in italian për ndihmën e tyre të vazhdueshme që i kanë bërë kësaj komune. Karriget stomatologjike janë ndarë për shkollën "Yll Morina" dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare në "Dardani".



## Gjykata Supreme vendos të numërohen 4 639 votat e diasporës



**Prishtinë, 30 tetor (ER)** - Gjykata Supreme të mërkurën sërish ka vendosur në favor të ankesës së Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për pranimin dhe numërimin e votave të diasporës. Vetëvendosje nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se ka pranuar vendimin nga gjykata me të cilin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve obligohet që t'i numërojë 4 639 votat e diasporës të ardhura pas 5 tetorit. "Vendimi i Gjykatës Supreme konfirmoi ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje. Morëm vendimin nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ku u konfirmua e drejta e bashkatdhetarëve tanë dhe u hap rruga për numërimin e pakove me vota të ardhura prej tyre. Presim që sa më parë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të mblidhet dhe ta marrë vendimin për t'i vijuar procedurat e verifikimit dhe numërimit të këtyre fletëvotimeve. E gjitha kjo mund të ishte evituar nëse prej 12 tetorit KQZ-ja do ta kishte lejuar administratën e KQZ-së që t'i numëronte këto fletëvotime", është thënë në komunikatën e Vetëvendosjes.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) u bë prezantimi për strategjinë për Armë të Vogla dhe të Lehta

# Zeka: MPB-ja ka zbatuar me sukses fushatën për legalizimin e armëve




"Ministria e Punëve të Brendshme, me përkrahje nga UNDP-ja, ka zbatuar me sukses fushatën për legalizimin e armëve e cila ka filluar më 17 dhjetor 2018 dhe ka përfunduar më 17 shtator 2019. Që nga fillimi i fushatës e deri në ditën e përfundimit të saj kemi pranuar rreth 2 000 kërkesa për legalizime, 11 kërkesa për çaktivizim, si dhe dy kërkesa për shkatërrim të armëve të zjarrit", ka thënë zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh Koordinator Nacional për Armë të Vogla dhe të Lehta (AVL), Izmi Zeka

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 30 tetor** - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) të mërkurën është bërë prezantimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) për zbatimin e udhërrëfyesit, duke përfshirë prioritetet kryesore.

Konferencën e hapi zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, njëherësh Koordinator Nacional për AVL, i cili ka thënë se në takimin e dytë lokal koordinues Kosova është e përkushtuar në Podgoricë dhe Londër për ta miratuar këtë udhërrëfyes, gjithashtu është e përkushtuar dhe shumë serioze që ta zbatojë në përpikëri dhe në mënyrën sa më të mirë të mundshme. "Ministria e Punëve të Brendshme, me përkrahje nga UNDP-ja, ka zbatuar me sukses fushatën për legalizimin e armëve e cila ka filluar më 17 dhjetor 2018 dhe ka përfunduar më 17 shtator 2019. Që nga fillimi i fushatës e deri në ditën e përfundimit të saj kemi pranuar rreth 2 000 kërkesa për legalizime, 11 kërkesa për çaktivizim, si dhe dy kërkesa për shkatërrim të armëve të zjarrit", ka thënë Zeka.

Zëvendësministri Zeka ka bërë me dije se po punohet rreth harmonizimit të ligjeve përkatëse me direktiva të BE-së të vitit 2017 dhe me rregulloret përkatëse.

Ambasadorja e Francës në Kosovë, Marie Christine Butel, ka vlerësuar punën që po bëhet në këtë drejtim dhe ka konfirmuar përkrahjen e shtetit francez për këtë iniciativë. "Më lejoni t'ju siguroj se shteti i Francës do të vazhdojë t'ju ofroj mbështetje për zbatimin e planit tuaj dhe shpresoj që së bashku do të arrijmë suksese gjatë këtij procesi për një mjedis të sigurt për të gjithë", është shprehur Butel.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte që të rishikohet statusi i zbatimit të udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme të armëmbajtjes pa leje dhe trafikimit të armëve të Vogla dhe të Lehta dhe të municioneve në Ballkanin perëndimor, të zhvilluar deri në vitin 2024 si pjesë e nismës franko-gjermane dhe planin e miratuar në Kosovë.

## PZAP-i refuzon kërkesën e Nismës për votat nga Serbia




**Prishtinë, 30 tetor (ER)** - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka hedhur poshtë ankesën e koalicionit Nisma-AKR-PD me të cilën ka kërkuar që të anulohen si të parregullta fletëvotimet e ardhura nga Serbia përmes postës për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Sipas PZAP-së, kërkesa e koalicionit Nisma-AKR-PD për anulimin e fletëvotimeve të ardhura nga Serbia është hedhur poshtë për shkak se ka skaduar afati i paraparë për ankesa. Nisma kundër vendimit të PZAP-it do të ankohet në Gjykatën Supreme.

# Shtegu i arsimit parauniversitar



Prof. Asoc. Dr. Arben DËRMAKU

Duke vrojtuar zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë ndeshemi me rezultate jo të kënaqshme. Ky ilustrohet me testet e pavarura që aplikohen në Kosovë, por me karakter ndërkombëtar. Të thuash se nuk kemi qenë të vetëdijshëm deri më tani lidhur me këtë gjendje është jo e saktë për faktin se në këtë fushë është investuar me qindra miliona euro që nga viti 1999. A janë investuar këto mjete me vend, mbetet dilemë për shkak të rezultateve të dobëta në testimet ndërkombëtare.

Konstatimi i gjendjes së keqe në arsimin parauniversitar është i lehtë, por në të njëjtën kohë kërkon shtegun e daljes nga kjo situatë. Trendët e numrit të nxënësve në shkollat në Kosovë janë në ulje kur kemi parasysh lëvizjet e popullsisë dhe shpopullimin e Kosovës. Program shtetëror në Kosovë do të duhej të ishte aplikimi i mësimit tërëditor si masë që do të ndikonte dukshëm në kohën e kaluar në mësim të nxënësve. Ky program do të duhej të kishte përkrahjen e qeverisë, prindërve dhe mësimdhënësve. Realizimi i këtij programi do të ndikonte substancialisht në rritjen e rezultateve të nxënësve. Kapacitetet fizike për zbatimin e këtij programi ekzistojnë sidomos në qendrat rurale dhe komunat e vogla. Ndërtimi i kapaciteteve të reja konform realizimit të këtij programi do të duhej të ndodhte në Prishtinë dhe në disa qytete më të mëdha të Kosovës. Ky do të ishte parakushti i kthesës për aplikimin e dijeve nga nxënësit kosovarë.

Ajo që është më kruciale për të pasur sukses në të nxënit e nxënësve në Kosovë është aplikimi i një modeli adekuat të mësimit që ka rezultate në testet ndërkombëtare. Kjo do të duhej të aplikohej në formatin që do të merrej mostra e 10 vendeve me rezultate më të mira të themi në testin PISA nga do të zgjidhej një prej këtyre shteteve si yrnek për arsimin parauniversitar në Kosovë. Aplikimi i modelit do të kërkonte në dimensionin kohor nja dy vjet, vitin e parë përcaktimi i trajnerëve nacionalë që do të shkonin për një vit në këtë vend të përcaktuar për t'u pajisur me metodat e mësimit dhe kopjimin e këtyre metodave me qëllim aplikimin në Kosovë. Vitin e dytë do të duhej të zbatohej modeli dhe do të na nevojitej ekspertizë nga ky shtet për të asistuar në konkretizimin e këtij modeli.

Në këtë aktivitetet do të duhej edhe implikimi i fakulteteve të edukimit në Kosovë për t'i pajisur studentët me dije për zbatimin e modelit të mësimit në arsimin parauniversitar. Kjo nënkupton edhe adaptimin e programeve mësimore konform shtetit të zgjedhur për model. Kjo nënkupton edhe përgatitjen e profesorëve për këtë aktivitet përmes vizitave studimore.

Për përcaktimin e modelit, përkatësisht shtegut, kërkohet gatishmëri e qeverisë për të mbështetur këtë aktivitet në aspektin financiar dhe moral.

**(Autori ka qenë këshilltar i ministrit të MAShT-it në periudhën shtator 2017 - gusht 2018)**

# Dëshpërimin ndaj BE-së të mos e shndërrojmë në devijime strategjike gjeopolitike



Prof. Lisen BASHKURTI



Ashtu siç e kishim parashikuar, vakuumi që la BE-ja me moshapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut po shndërrohet në avantazhe nga Rusia, e cila fton këto dy vende të dëshpëruara që t'i bashkohen Unionit Ekonomik Euro-Aziatik. As në politikë dhe as në gjeopolitikë nuk ka zona të zbrazura, palët rivalizuese shfrytëzojnë çdo çast për ta shtrirë praninë, ndikimin dhe interesat e tyre. Rusia me veprimet e saj po ndihmon Ballkanin dhe BE-në për të qartësuar më mirë për tektonikat gjeopolitike të shkaktuara nga dobësitë e të dy palëve: vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të BE-së.

Serbia tanimë është deklaruar për t'iu bashkuar këtij Unioni me Rusinë në qendër. Kjo është paralajmëruar nga disa kohë më parë. Edhe Shengeni serbo centrist - Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Serbi është një 'paradhomë' hyrëse për në këtë union rus.

Dhëntë Zoti që Shqipëria, por edhe Maqedonia e Veriut, të mos e shndërrojnë dëshpërimin ndaj BE-së për moshapjen e negociatave në devijime gjeostrategjike, nga euroatlantizmi drejt Euro-Azisë.

Kambana bie për t'u dëgjuar. Ariu polar nuk fle edhe kur i mban sytë mbyllur, ndërkohë që Ballkani dhe BE-ja duket se flenë edhe kur i mbajnë sytë hapur.

Sa keq ndodh kur harrohet historia!

## MAShT-i përkrah zhvillimin e programit për edukim mjedisor

**Prishtinë, 30 tetor (ER)** - Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për pasurimin e programit mësimor ekstra kurrikular për nxënësit në Kosovë dhe me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të shoqërisë civile me institucionet e vendit, ministri në detyrë i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), Shyqri Bytyqi dhe drejtoresha e Green Art Center - Prishtina (GAC), Merlina Beu-Muçaj, kanë zhvilluar një takim pune, në të cilin kanë diskutuar për aktivitetet mjedisore në kuadër të programit të GAC-it për edukim mjedisor në institucionet arsimore. Në këtë takim është veçuar rëndësia e aktiviteteve jashtë mësimore nëpër shkolla, roli i nxënësve dhe studentëve për ngritjen e vetëdijes qytetare në komunitetin e gjerë dhe aktivizmi qytetar. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka ofruar mbështetjen duke u shprehur se MAShT-i është i përkushtuar që në vazhdimësi t'u ofrojë mbështetje organizatave të shoqërisë civile me të cilat ndan qëllimin e përbashkët, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe edukimin e brezave të rinj me programe dhe aktivitete bashkëkohore me impakt për shoqërinë në Kosovë. Përmes aktiviteteve të shumta që GAC-i zbaton, synohet sensibilizimi i qytetarëve dhe edukimi i brezave të rinj për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe zbatimin e reformave të ndryshme që kanë nisur nëpër komuna në Kosovë.



# Hapet edicioni i katërt i Festivalit të Gjelbër

Prishtinë, 30 tetor (ER) - Në sallën e sporteve "1 Tetori" në Prishtinë të mërkurën është hapur festivali dyditor i cili ka për qëllim promovimin e bizneseve të gjelbra në Kosovë dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe interesimit për riciklim, energjinë e ripërtërirë dhe energjinë efiçiente. E veçanta e këtij festivali sivjet është përfshirja e sektorit të ndërtimit si konsumues të mëdhenj të të gjitha këtyre produkteve.

Kryetari i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, ka deklaruar se sektori i prodhimit ka promovuar gjithmonë produktet "Made in Kosova". "Ne si sektor i prodhimit gjithmonë i kemi promovuar produktet 'Made in Kosova', duke marrë parasysh edhe qëndrueshmërinë e ambientit që të kemi zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik është kur ne e mbrojmë ambientin, investojmë në ambient dhe që resurset të cilat i shfrytëzojmë përpiqemi që sa më pak të kenë ndikim në jetën dhe ambientin përreth. Një festival i tillë ka për qëllim t'i mbledhë të gjitha këto raste vjetore që janë investime në këtë sektor dhe t'i prezantojë në një panair të tillë", ka thënë Panxha.

Festivali i Gjelbër i këtij viti organizohet nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës.

Në këtë panair marrin pjesë prodhues të sektorëve të ndryshëm, instalues që importojnë produkte nga vende të tjera, por që qëllimin e kanë te energjia efiçiente, riciklimi dhe të energjia e ripërtërishme. Këtë vit 45 kompani dhe organizata nga Kosova do t'i ekspozojnë produktet e tyre në pavijonin e gjelbër. Edicioni i katërt i Festivalit të Gjelbër do të përfundojë sot (e enjte).



# ANP 'Adem Jashari', storie e suksesit në Amadeus IT Conference 2019

Prishtinë, 30 tetor (ER) - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" ishte ftuar nga Amadeus për t'i prezantuar sukseset e kompanisë, procesin e privatizimit deri te rritja enorme e numrit të udhëtarëve dhe fluturimeve si dhe planet në të ardhmen.

Prezantimi i ANP "Adem Jashari" ishte ndryshimi i sistemit në Amadeus me temën "Duke ecur përpara në udhëtimin tonë të transformimit". Këto suksese u shpalosën para shumë përfaqësuesve të lartë të fushës së aviacionit nëpër botë, duke diskutuar për zgjerimin e perspektivave drejt ndryshimit pozitiv, gjithmonë duke pasur në fokus rritjen e kualitetit të shërbimeve ndaj klientëve.

Shefi ekzekutiv i Operimeve, Gokmen Aritay, në konferencën e organizuar në Aeroportin Ndërkombëtar të Mynhenit ka theksuar: "Lëvizja në platformën Amadeus ose Altea na lejon neve që ta ngrehim nivelin e kënaqshmërisë dhe përvojës së udhëtarëve për çdo ditë. Për më shumë duke kaluar në Altea BRS (sistemi i pranimit të bagazheve) ne jemi bërë si një ndër aeroportet e para që ofron shërbimin e IATA Res 753 që rekomandohet nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror".

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës vazhdon të ketë rritje të numrit të udhëtarëve duke shënuar kështu një rritje prej 11 përqindësh në numër udhëtarësh dhe 13.09 për qind në numër fluturimesh.




# KEDS-i vendos tri trafo të reja në Stanovc të Vushtrrisë

Vushtrri, 30 tetor (ER) - Mbi 270 familje të Stanovcit të Vushtrrisë tashmë kanë shërbime shumë më kualitative me energji elektrike, pasi që KEDS-i ka ndërtuar tri trafo të reja për nevojat e banorëve të këtij fshati dhe ka ndërruar të gjitha shtyllat që kanë qenë me përçues të zhveshur, duke vendosur 250 shtylla të reja. Gjithashtu, janë shtrirë rreth 13 kilometra rrjet elektrik në tensionin e ulët dhe të mesëm, kurse kyçjet shtëpiake janë me bërë me kabllo nëntokësore. Kjo ka bërë që edhe banorët e këtij rajoni t'i hetojnë këto ndryshime, sidomos lagjja Haradinaj që ka 176 familje dhe lagjja Haxhaj 97 sish. Këto punime kanë rritur kapacitetet energjetike dhe tani tensioni do të jetë stabil dhe banorët e kësaj ane më nuk do të kenë probleme me rrymë për vite të tëra, duke iu larguar edhe rreziku nga rrjeti i vjetër.



Për Liman Haxhaj, banor i kësaj lagjeje, ka qenë ëndërr largimi i shtyllave nga oborri. "Është fakt se po bëhet një punë e madhe. Po bëhet një mrekulli", ka thënë ai. Edhe konsumatori Haki Pronaj, nga lagjja Haradinaj, ka pohuar se është shumë i kënaqur me këto ndryshime në fshatin e tij. "Deri tash ka qenë tmerr. Sa herë frynte era ndalej rryma. Tri herë na janë këputur telat dhe na kanë rënë mbi garazh. Tash është në rregull", ka thënë Pronaj.

KEDS-i po vazhdon investimet në shumë vendbanime të Kosovës për ta modernizuar rrjetin elektrik, e që është një zotim i kompanisë për t'i zgjidhur problemet infrastrukturore për shpërndarjen e energjisë elektrike.

# RAPORTI I INSTITUTIT ZVICERAN PËR R

**Gazeta "Epoka e re" në vazhdime do t'i botojë dy raportet e përkthyera në gjuhën shqipe, njërin prej 44 faqesh dhe tjetrin prej 15 faqesh, të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, për rastin e Astrit Deharit. Këto dy raporte tashmë i ka Prokuroria Themelore në Prizren, familja e Astrit Deharit dhe avokati Tomë Gashi. Raporti publikohet pa asnjë ndërhyrje.**

- 1 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën renale me indikacionet e mëposhtme :
  - MA16-286/5 Veshkë – H/E
- 1 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën hepatike me indikacionet e mëposhtme :
  - MA16-286/6 Mëlçia – H/E
- 3 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën encefalike me indikacionet e mëposhtme :
  - MA16-286/7 Truri – H/E (tru i vogël)
  - MA16-286/7 Truri – H/E (korteksi cerebral)
  - MA16-286/7 Truri – H/E (bërthama e gri qendrore dhe ura)
- 1 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën surenale me indikacionet e mëposhtme :
  - MA16-286/8 Adrenale – H/E
- 1 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën splenike dhe pankreatike me indikacionet e mëposhtme :
  - MA16-286/8 Sh/Pan – H/E

Në vazhdim të ekzaminimit e prerjeve histologjike, ne kemi bërë konstatimet në vazhdim:

Parenkima encefalike

Të gjitha kampionet e bëra në niveli e trurit, trurit të vogël dhe trungut cerebral nuk tregojnë asnjë lëndim ishemike, hemorragjik, inflamator, malformatik ose tumoral. Popullata neuronale e urës është e pranishme normale dhe pa shenjë iskemie. Në nivelin cerebral, neuronet e bërthamës së dhëmbëzuar dhe qelizat e Purkinje janë normalisht të paraqitura dhe pa shenja iskemike.

Parenkima kardiake

Epikardi është mirë. Fibrat muskulor të miokardit janë të radhitur në rregull dhe m e një diametër të mesëm. Miocitet kardiake kanë skaje citoplazmatike mirë të dukshme dhe hullizime të ruajtura. Nuk ka pigmentim të veçantë në citoplazmë. Bërthamat janë të madhësisë së zakonshme dhe janë pa atipike. Nuk ka infiltrat inflamator të miokardit as edhe të epikardit. Enët e epikardit paraqesin nganjëherë disa trashje të intimes. Disa arteriole të vendosura në gjirin e miokardit paraqesin një mur të trashë. Nuk ekziston çerdhja e fibrozës ose e lipomatozës. Endokardi është mirë.

Parenkima pulmonare

Pleura është mirë. Alveolat janë me vëllim të zakonshëm përveç në disa zona subpleurale ku ato janë me vëllim të rritur, por ku nuk shihet këputje e murit alveolar. Në të gjitha kampionet, alveolet janë të mbushura me globule të kuqe dhe me material eozinofilik amorf. Për ndryshe, vërehet në mënyrë shpërndarëse në gjirin e bronkeve, bronkioleve dhe alveoleve, material ushqyes vegjetal në formë të strukturave eozinofile dhe amorfe, nganjëherë në formë të shtirë, e nganjëherë në formë të rrumbullak dhe ovale që paraqesin si kasollëza të zbehta, si dhe fragmente të muskulit skeletik. Nuk ka infiltrime inflamatore të rëndësishme dhe në veçanti nuk vërehet qeliza gjigande shumë bërthamore e llojit të një trupi të huaj. Septat inter-alveolare identifikohen mirë dhe përbëjnë kapilarë të mbushur me globule të kuqe (kongjestive). Bronket dhe bronkiolet paraqesin një mur me strukturë normale dhe përmbajnë shpesh material ushqimor vegjetal dhe shtazor. Hapësirat peribranshial janë me strukturë të zakonshme. Strukturat vaskulare janë pa lëndime.

Parenkima hepatike

Kapsula është mirë. Arkitektura e parenkimës është e rregullt, me lobule hepatike mirë të formuara dhe me hapësira hepatocitare me madhësi normale. Venat centrilobular dhe sinuzoidet janë pa ndonjë veçori. Hapësirat janë me madhësi normale me struktura vaskulare dhe biliare të zakonshme dhe pa lëndime. Në lobulën hepatike, hepatocitet janë anormale.

Parenkima renale

Glomerulat janë në numër të zakonshëm dhe celulariteti nuk është rritur. Membranat themelore nuk janë trashur. Matrica ekstra qelizore pa përmbajtje anormale. Tubthat janë të kalibrit normal, të veshura me qeliza të renditura rregullisht dhe pa ndryshime. Drita e tubthave është e zbraztë. Interstici nuk është e zgjeruar. Nuk ka infiltrim infalamator tubular e as intersticial. Strukturat vaskulare janë të pa lënduara. Vërehet një mbushje vaskulare (kongjestive) në nivelin e papillae (sythave) renale.

Parenkima subrenale

Parenkima subrenale është me një arkitekturë normale me një dukshmëri të korteksit dhe të medullas. Petëzim kortikal shihet mirë dhe pa lëndime. Medulla është pa lëndime.

Parenkima splenike

Parenkima splenike ka një arkitekturë të ruajtur me pamje të mirë të substancës së bardhë dhe të substancës së kuqe s'ka lëndime të këtyre të fundit.

Parenkima e pankreasit

Parenkima është e lobuluar me një përbërës endokrin ( ishujt e Langerhans) dhe ekzokrin (acini) mirë i zhvilluar dhe pa lëndime. Kanalet sekretues nuk janë të zgjeruar. Nuk ka inflmacion.

Mbi bazën e ekzaminimit të prerjeve histologjike, ne mund të ruajmë diagnozën histopatologjike në vazhdim:

- Edeme pulmonare hemorragjike e përhapur.
- Kongjestioni pumonar i përhapur.
- Bronkoaspirimi i përhapur me material ushqyes.

**c. Albumi fotografik i vendit të zbulimit të trupit**

Ne kemi pranuar një album fotografik në skedarin Microsoft[R] Word të titulluar "5.Fotoalbum 2016-GA-2746 TK-90-2016 (NXPPowerLite Copy)" që përmban 183 forografi me ngjyra dhe legjendë të vendit të zbulimit të trupit. Duhet të theksohet se fotot në formatin digjital nuk na janë dërgua.

Në vazhdim të ekzaminimit të këtij albumi fotografish, ne kemi bërë këto konstatime:

- Asnjë fotografi e trupit të z. DEHARI Astrit në qeli nuk është në dispozicion ( për të rikujtuar, trupi i z. DEHARI është transferuar në lokale të ndryshme pas zbulimit të tij, për një kujdes mjekësor),
- Numër i madh objektesh të shpërndara mbi tokë të qelisë,
- Gjurmët e një materiali të kuqërremtë që evokon gjak që njollos tokën e qelisë,
- Gjurmë të materialit të përhinte janë të dukshme mbi tokë,
- Mbi tokë pjesët kryesore, vërehen në veçanti objektet e mëposhtme:
  - Një shishe plastike që paraqet një ari të vogël, me skaje të lëmuara, një pjesë e mbuluar me material ngjyrë kafe, me madhësi 17 cm e gjatë me një bazë me madhësi rreth 5cm të diametrit në pjesën më të skajshme dhe përafërsisht 6cm rreth 1.5 cm të këtij ekstremiteti të skajshëm,
  - Një sapun drejtkëndësh ngjyrë roze, i mbuluar pjesërisht me material ngjzyrë kafe me madhësi rreth 5 x 7,7cm,
  - Një sfungjer i mbështjellë me një këmishë të zezë,
  - Një lidhëse e klatër e këpucave me madhësi prej 57cm,
  - Një çajnik me kabull elektrike (asnjë fotografi në dispozicion nuk mundëson të vlerësohet gjatësia e kabllos),
  - Një grumbull peshqirësh, disa të përmbajnë gjurmë ngjyrë kafeje,
  - Një grumbull shtupa pambuku, disa me gjurmë ngjyrë kafeje,
- Brisqe rroje shihen në një kosh mbeturinash të dhomës kryesore (me gjurmë të kuqërremta që paraqesin gjak) dhe në një kosh të bardhë i vendosu në tokë (pa gjurmë në sipërfaqe). Shumë brisqe rroje shihen në veçanti në sirtarët e qelisë ( s'ka fotografi në një rrafsh të afruar në dispozicion),
- Lidhur në një krevat, shihet një "sigjim" të përhinë, me gjatësi prej 85 x 05 cm,
- Në xhepin e një xhakete të varur në krevat, shihet një "sigjim" gri madhësia e të cilit nuk mund vlerësohet me rezolucione të fotografive në dispozicion,
- Në tualet:
  - Mbi tokë, gjendet një stilolaps që përmban gjurmë të kuqe që evokojnë gjak, i lidhur me një lidhëse blu-zezë që evokon një lidhëse këpucësh me madhësi përafërsisht 25 cm e gjatë ( vështirë për ta matur mbi fotografitë në dispozicion),
  - Mbi tokëm në një legen, gjenden copa të zhytura në një lëng me disa flluska në sipërfaqe, që evokojnë rroba të ulura në ujë me sapun.
  - Mbi lavamanin metalik shihen gjurmë të skuqura që evokojnë gjak
  - Në lavamanin metalik, një brisk rroje me gjurmë të skuqura që evokojnë gjak

**IV. PËRMBLEDHJE DHE DISKUTIME**

**a. Hetimet policore**

Në bazë të të gjitha hetimeve të kryera nga autoritetet lokale mbi vendin e gjetjes së trupit, ne u hedhim një vështrim elementeve të më poshtme:

- Mbi dyshemenë e qelisë A3 gjendeshin këto elemente:
  - gjurmë gjaku
  - gjurmë të materialeve të kuqërremtë mbi dysheme,
  - një sfungjer e mbështjellë në një këmishë të zezë e ndotur me një material që evokonte jargë dhe vjellje,
  - një lidhëse e kaltër me madhësi rreth 58 cm,
  - peshqirë me material të kuqërremtë që evokonte gjak,
  - një shishe plastike me kapak të verdhë:
    - që përmbante lëngë që evokonte mjaltë
    - pjesërisht e mbuluar me material ngjyrë kafeje që evokonte gjurmë gjaku,
    - me skaje të lëmuara
    - me madhësi rreth 17 cm e gjatë me një bazë me diametër rreth 5 cm të pjesës së saj më të skajshme dhe rreth 6 cm me rreth 1,5 cm të këtij ekstremiteti të skajshëm,
  - një çajnik me një kabull elektrike të gjatë 90 cm,
  - një sapun kënddrejtë, pjesërisht i mbuluar me materia ngjyrë kafeje që evokonte gjak, me madhësi rreth 5 x 7,7 cm,
  - një brisk rroje me 5 tehe i mbuluar me pika të kuqe që evokonin gjak.
- Varur për krevati gjendeshin objekte prej najloni që formonin një lloj litari, më i gjati 1 x 85 cm dhe më i shkurti 1 x 36 cm.
- Në tualet gjendeshin këto elemente:
  - gjurmë gjaku mbi dysheme,
  - një stilolaps që përmbante gjurmë të kuqe që evokonin gjak, i lidhur sigurisht me një lidhëse këpucësh,
  - një lavaman prej metali mbi të cilin gjurmë gjaku ishin të dukshme,
  - në lavaman, një pjesë metalike që dyshohet se ishte brisk rroje me gjurmë të kuqërremta evokim i gjakut.

bazë të hetimeve tjera policore, ne u hodhëm një vështrim këtyre elementeve

- Bashkë mbajtësit e z. DEHARI, z. MAKOLLI Naser, z. LASKU Frrok dhe z. GASHI Adonis, nuk paraqitnin lëndime, sipas konstatimeve të policisë të bëra më 17 nëntor 2016, që do të thotë 12 ditë pas vdekjes së z. DEHARI Astrit. Duhet të vihet re menjëherë ky afat është shumë i gjatë dhe se gjurmët eventuale ose lëndimet kanë mundur ndërkohë të zhduken.
- Gjurmët digjitale të pa shfrytëzueshme ishin të pranishme në kutinë prej plastike, një çajnik dhe një orë.
- Asnjë përzierje e gjurmëve digjitale nuk është identifikuar mbi bartësit e ndryshëm të analizuar në qeli ose mbi rrobat e z. DEHARI. Këto rezultate janë papritura në një dhomë që banonin 4 individë. Për këtë arsye, ne jemi në dispozicion për analiza gjenetike të mëvonshme.
- Nuk kishte evidencë manipulimesh të regjistrimeve vise të qendrës së paraburgimit në Prizren (ekzaminim i pavarur austriak).

→

# ASTIN E VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT

- Regjistrimet video kanë zbuluar elementët e më poshtme:
  - Z. DEHARI e ka marrë shujtën e vetë (12:58)
  - Z. DEHARI ka shkuar në dush (13:50)
  - Z. DEHARI kthehet në qeli pas dushit (14:09); duke u nisur nga ky moment, ai nuk del më nga qelie.
  - Një i mbajtur del nga qelia A3 në korridor, shikon dhe kthehet prapë në qeli (14:11),
  - Gardiani e inspekton qelinë A3 dhe e mbyll derën (14:11).
  - Dy të mbajtur dalin nga qelia A3 (14:52)
  - Një i mbajtur del nga qelia me një kasketë dhe me veshje sportive (14:52).
  - "Të gjithë të mbajturit lëshojnë korridorin për në shëtitje"(14:53).
  - Gardiani afrohet tel qelia A3, ngrit dorën sikr të bënte një përshëndetje dhe e mbyll derën (14:53).
- Proceset verbale të zbulojnë këto elemente:
  - Z. DEHARI është përshkruar nga bashkë mbajtësit dhe nga gardianët si një njeri i qetë, pa probleme, që kishte marrëdhënie të mira me bashkë mbajtësit dhe gardianët. Ai nuk vuante nga asnjë presion nga askush, përfshirë këtu edhe gardianët.
  - Bashe mbajtësit e tij nuk mendonin se do të kishte mundësi t'i bënte keq vetes.
  - Z. DEHARI e kishte shkruar në bllokun e tij adresën e një nga bashkë mbajtësit (z. MAKOLLI), një seri numrash telefonikë të anëtarëve të familjes dhe miqve. Arsyeja për këtë ishte se z. DEHARI dëshironte që Z. MAKOLLI të paralajmërojë rrethin e tij në rast se transferohej në burg për hetime nga ana e policisë ose e Ministrit publik. Avokati i tij do të duhej gjithashtu të paralajmërohej.
  - Më 5 nëntor 2016 z. DEHARI nuk ishte i mërzitur dhe nuk kishte sjellje të pazakonshme.
  - Më 5 nëntor 2016, gjatë dushit z. DEHARI është rruar me një brisk rroje dhe pastaj ia ka kthyer gardianit.
  - Më 5 nëntor 2016 z. DEHARI ka qëndruar në qeli, duke thënë (sipas dëshmitarëve) se nuk ndjehej mirë, kishte dhimbje koke, dhe parashikonte të bënte një thirrje telefonike dhe ta pastronte qelinë.
  - Z. MAZREKU ishte i mbajtur në qelin A2 dhe gjendje në qelinë e tij gjatë shëtitjes së mbajtësve pasi që nuk ndjehej mirë. Gjatë kësaj kohe, ai ishte vetëm në qeli, gjysmë i fjetur. Por rreth fundit të shëtitjes, përafërsisht 10 minuta para se të vinin të tjerët, ai ka dëgjuar dy ose tri zhurma të lehta, pa pasur mundësi që të jepte më shumë saktësi sa i përket natyrës së zhurmave as edhe të tregonte prej nga vinin.
  - Gjatë zbulimit të z. DEHARI nga bashkë mbajtësit, ai ishte në shpinë, në tokë, me një shishe mjalti prej plastike të vendosur në gojën e tij nga pjesa e prapme. Shishja ishte, sipas një dëshmitari, e futur më shumë se gjysma. Ai paraqet në veçanti lëndime në nivelin e pjesës së djathtë të qafës së tij dhe të kyçit të majtë. Ai ishte i lagur në nivelin e organeve gjenitale të jashtme.
  - Gardiani, z. KASTRATI, i ka dhënë ndihmën e parë duke e larguar shishen prej plastike rreth 5 cm në gojën e tij. Pasi që e hoqi shishe, ai konstatoi se z. DEHARI lëvizte gojën e tij dhe se ajri dilte nga goja e tij.
  - Infermierja intervenon aty për aty dhe ka konstatuar se të vjella gjendeshin pranë z. DEHARI. Ajo ka konstatuar se ai kishte një puls në nivelin e qafës dhe se ai merrte frymë.
  - Ekipi mjekësor që intervenon pastaj në qendrën e paraburgimit nuk ka konstatuar shenja jete.

**b. Dosja mjeko-psiko-socilae e z.DEHARI Astrit**

Në rrefshin somatik, ne mund të ruajmë elementet e mëtejme që kanë të bëjnë me z. DEHARI Astrit:

- asnjë sëmundje kronike
- nuk konsumon alkool,
- ka migrenë,
- nuk ka trajtim.

Në rrafshin psikologjik ne mund të ruajmë elementet e mëtejme që kanë të bëjnë me z. DEHARI Astrit:

- gjendja psikologjike e mirë dhe stabile,
- nuk ka prejardhje psikologjike ose psikiatrike,
- s'ka mendime ose tentativa për vetëvrasje në të kaluarën,
- s'ka mendime vetëvrasëse gjatë takimeve me psikologët në qendrën e paraburgimit në Prizren (6 dhe 8 shtator 2019),
- gjumin dhe apetitin e ruajtur,
- vullnet të mirë.

Në rrafshin e analizave psikiatrike të shkrimeve të tij ne mund të ruajmë elementet e mëtejme që kanë të bëjnë me z. DEHARI Astrit:

- s'ka nocion krize emocionale të rëndë as edhe shkëputje të mëdha emocionale,
- prani e një gjendjeje emocionale që ngarkohet kohë pas kohe sa u përket perceptimeve, të ditës, të situatës politike, nganjëherë, ai shprehte mërzi, pasiguri dhe një pesimizëm,
- disa nga shkrimet reflektojnë një gjendje emocionale të ndjeshme dhe skeptike, është e mundshme që korrespondojnë me një gjendje emocionalisht të brishtë.

Në rrafshin social ne mund të ruajmë elementet e mëtejme që kanë të bëjnë me z. DEHARI Astrit:

- banon me familjen e tij,
- marrëdhënie të mira familjare (prindërit dhe motra),
- kushte të mira banimi,
- situatë të mirë ekonomike,
- thuhet i shoqërueshëm, i arsyeshëm (ang. "rational") dhe kishte shumë miq
- Z. DEHARI dukej i hapur, komunikativ dhe i qetë. Ai nuk paraqiste emocione shqetësuese as edhe vështirësi të përshtatjes në rrethin e tij.

**c. Autopsia e z. DEHARI Astrit dhe interpretimet mjeko-ligjore**

Diagnoza anatomo-patologjike (sipas vlerësimit tonë):

- në nivelin e regjionit frontal superior, katër pllaka të pergamene, mediane dhe paramediane e djathtë, pjesërisht të mbuluara me flokë,
- në nivelin e konjuktive bulbaire[7] bilaterale dhe të konjuktiva palpebrale inferiore bilaterale dhe petechiae[8],
- në nivelin e këndit mandibular të djathë, një ecchymosis[9] e kuqe-murrme dhe ovale,
- në nivelin e bregut anterior-inferior të djathtë të mandibulës, një ecchymosis e kuqe-murrme dhe ovale,
- në nivelin e regjionit pre-artikular të majtë një dermabrasion[10] i kuqërremtë, me madhësi dhe formë të ndryshme latero-cervikal i djathtë:
  - shumë plagë sipërfaqësore me skaje të pastra, të grupuara, lineare, të pjerrëta poshtë dhe para trupit, të skuqura dhe gati paralele në mes veti,
  - shumë plaka të pergamene, të pjerrëta të drejtuara poshtë përpara trupit, të skuqura, globalisht paralele në mes veti, të vendosura në pjesën superiore të plagëve të përshkruar më lartë,
  - plaka të pergamene të skuqura, madhësi dhe forma të ndryshme, disa në formë harku, rregulluara mes tyre, veçanërisht në formë harku të rrethit me konkavitet anterior, të vendosura në nivelin e pjesës shumë anteriore plagë dhe dermabrasione të përshkruara më lartë.
- në nivelin e regjionit pre-sternal, pektorli i majtë dhe latero-torakal i majtë, ecchymosis vjollce dhe pllaka të pergamene të skuqura, me madhësi dhe forma të ndryshme, disa "në formë",
- në nivelin e palosjes së bërrylit një aspekt i kuqërremtë dhe i rrumbullak i cipave, i rrethuar me një ecchymosis të kaltër,
- në nivelin e faqes mediale dhe distale dhe para krahut të djathë, tri ecchymosis të kuqe-kafe, të rrumbullakëta dhe ovale, dy prej të cilave janë të vendosura në të njëjtin aks longitudinal, rreth 0,9 cm njëra nga tjetra,
- në nivelin e faqes dorsale të gishtit të tretë të dorës së djathtë, mund të shihet nga artikulacioni metakarpo-falangal, një ecchymosis e kuqe-kafe dhe ovale,
- në nivelin e faqes posteriore të bërrylit të majtë, shumë plagë sipërfaqësore me skaje të pastra, të grupuara, lineare, horizontale, të kuqërremta, gati paralele njëra me tjetrën,
- në nivelin e faqes anteriore të tiers distal, të parakrahut të majtë, rreth 5 cm mbi plagët sipërfaqësore të përshkruara më lartë, një pllakë pergamene e kuqërremtë gjatore në kontakt me një cikatricë e hipopegmentuar,
- në nivelin e secilit breg lateral të bazës së gjuhës, dilaceration linear, me skaje të pastra, jo hemorragjik dhe simetrik,
- në nivelin e bregut lateral të djathtë të gjuhës, i vendosur reth 1,7 cm nga dilaceratoni i përshkruar më herët, një dilsceration sipërfaqësor, në formë harku me konveksitet superior,
- në nivelin e pjesës posteriore të raphe[11]i mesëm i qiellzës së butë , një ngjyrim kuq-vjollce e mukozës që evokon një zonë të infiltrimit, hemorragjik,
- në nivelin e pjesës posteriore paramediale të djathtë të qiellzës së butë, një zonë e ngjyrosur kuq-vjollce të mikozës që evokon një zonë të infiltrimit hemorragjik,
- petechiae nën pleurë,
- një edeme pulmonare hemorragjike akute dhe e shpërndarë,
- një kongjestion pumonar i shpërndarë,
- një bronko-aspirim akut dhe i shpërndarë i materialit ushqimor,
- një frakturë e brinjë se 4 të majtë, pa reagim vital periferik
- edemë diskrete e trurit (pesha e trurit 1650 g.).

[7] Mukoza transparente që mbulon anën e brendshme të qepallave (konjunktiva tarsale) dhe veshë një pjesë të globit okular.
[8] Pikë e vogël që shfaqet në lëkurë pas hemorragjisë së lëkurës
[9] Eksuzion i gjakut në indin nën lëkuror pas një goditjeje, gjurmë të katërta rezultojnë pastaj.
[10] Dermabrasion është një lloj sipërfaqeje kirurgjikale e lëkurës, e cila zakonisht kryhet në një ambient mjekësor profesional nga një dermatolog ose kirurg plastik i trajnuar posaçërisht në këtë procedurë.

Komentimet mbi autopsinë dhe diagnozën anatomo- patologjike:

Regjistrimet video të autopsisë nuk përmbajnë sekuencat që tregojnë nxjerrjen e organeve të brendshme në një bllok të vetëm anatomik (metodë e Letulle), këto që janë të dukshme mbi tavolinë të autopsisë. Gjithashtu nuk përmban sekuencën që tregon autopsinë e gjuhës, autopsinë e qafës rrafsh për rrafsh dhe autopsinë e organeve të brendshme torako-abdominale.

Disa nga diagnozat anatomo-patologjike tonat dallojnë nga ato të paraqitura në raportin e autopsisë. Kemi të bëjmë me diagnozat në vazhdim:

- zonat lëkurore të kuqërreme, të rrumbullakëta dhe ovale, të përshkruara në nivelin e këndit të mandibulës së djathtë, të parakrahut të djathë dhe të dorës së djathtë, janë përshkruar nga mjekët ligjor si eritema. Një eritemë është një lëndim sipërfaqësor, e kuqërremtë, të çastit që zhduken me presionin e lëkurës. Kjo është pasojë e një zgjerimi transitor i enëve të lëkurës. Në bazë të fotografive dhe të videove në dispozicion, ngjyrimi i këtyre lëndimeve është i kuq-kafe. Këto lëndime pra duhet të konsiderohen si ecchymosis.

[11] në anatomi, një vijë mediane që ngjitet në një tendin ose ligament

Vijon në numrin e ardhshëm

# Rrugëtimi i Kosovës, drejt stabilizimit apo drejt shpërbërjes!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Situatë e re, sfida të reja: Procesi zgjedhor i 6 tetorit 2019 ishte teknikisht në rregull, një hap afër standardeve të përcaktuara ndërkombëtare. Ndotjen e këtij procesi e bënë disa komisionarë të papërgjegjshëm, të korruptuar dhe të komprometuar sikur edhe në të gjitha zgjedhjet paraprake. Lufta apo më mirë të them hajnia është bërë brenda llojit, brenda të të njëjtit subjekt politik, për faktin se nuk është lejuar hajnia midis subjekteve të ndryshme. Më shumë se 35 për qind të vendvotimeve shkuan në rinumërim. Pati veprime kriminale gjatë votimit; Lista Serbe i dërgoi në arkiv serbët e Kosovës që janë integruar apo që duan të integrohen në institucione të Kosovës me ndihmën e shantazhit, kërcënimeve dhe, sidomos, me ndihmën e Aleksandar Vuçiqit, presidentit të Serbisë, sikur edhe me ndihmën e ndërkombëtarëve në Kosovë që nuk ndërmorën asnjë veprim për të siguruar kushte të barabarta për të votuar dhe për t'u votuar aq më parë që prania e institucioneve kosovare në lokacionet ku jetojnë serbët ka qenë thuaja simbolike dhe jodomethënëse. Për këtë arsye "serbët e Albinit", sipas Beogradit, nuk kishin as gjasa teorike ta kalojnë Rubikonin. Në anën tjetër, edhe kandidatët për deputetë të PSD-së e pësuan keq pasi u "rrahën fort" nga votuesit. Po të shkonte e vetme në zgjedhje, PSD-ja do të ndahej shumë më mirë sikur që edhe AAK-ja do të ndahej më mirë po të mos shkonte bashkë me PSD-në. Më së keqi e ka pësuar Nisma që, përkundër të gjitha rregullave kombëtare dhe politike, u "martua" me AKR-në dhe PD-në e që ndikoi që pjesa më kombëtare e Nismës të mos votojë këtë koalicion. Jam shumë i sigurt se po të shkonte Nisma e vetme në zgjedhje pa asnjë problem do ta kalonte pragun zgjedhor, kështu gjatë bërjes publike të rezultateve, herë vdes (kur është nën 5 për qind) dhe herë ngjallet (kur mendon se është mbi 5 për qind).

Pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 e kemi një situatë shumë relaksuese, hiç këtu Nismën dhe disa kandidatë për deputetë; LV-ja doli fituese e zgjedhjeve, e dyta ishte LDK-ja, e treta PDK-ja si dhe e katërta AAK-ja. Partia e pestë ishte Lista Serbe kriminale që i fitoi të gjitha mandatet në Kuvendin e Kosovës. Dy partitë që ishin në pushtet, PDK-ja dhe AAK-ja, me një shpejtësi të pabesueshme deklaruan se i pranojnë rezultatet e zgjedhjeve dhe se do të kalojnë në opozitë duke kundërshtuar çdo mundësi të bëhen pjesë e pushtetit e që paraqet një standard të ri në Kosovë e që ka munguar më parë. Gjithashtu, dy të "dashuruarat" e kamotshme, LV-ja dhe LDK-ja, u deklaruan se do të lidhin kurorë politike dhe kanë mbetur disa çështje teknike për kushtet e martesës. Duket se kumbara kryesor i kësaj martese do të jetë ambasadori Kosnett, i cili do të përcaktojë përfundimisht kushtet e martesës apo do ta noterizojë këtë martesë, më herët të paimagjinueshme! Nëse më parë ndërkombëtarët këmbëngulnin që LV-ja të mos jetë pjesë e pushtetit, tash kanë filluar të bëhen nervozë pse LV-ja dhe LDK-ja nuk po nxitojnë të shkojnë në "shtratin e Prokrustit", të quajtur pushtet. Nuk ka asnjë arsye që të vonohet jetësimi i koalicionit që fitoi zgjedhjet dhe këtë vonesë mund ta bëjë LV-ja nëse votat e diasporës i dërgon në Gjykatë Kushtetuese. Janë bërë grupet teknike për ndarje të pushtetit midis LV-së dhe LDK-së ku hurin dhe burgjet i do LV-ja, kurse kuletën LDK-ja. Kjo ndarje, nëse është e vërtetë, i jep atribute LV-së si parti hakmarrëse dhe që dhunën do ta përdorë në vend të politikës aq më parë që "skifterët" e LV-së, ndonëse pa kthetra dhe të lodhur fare për shkak të moshës, vuajtjeve dhe mbushjeve negative, çdo ditë dërgojnë porosi të dhunës, dikur nga opozita dhe pa pushtet, kurse tani nga pozita dhe me pushtet. Pastaj po ka përgënjeshtrime, por se nuk po e kanë forcën e kërcënimit. Realisht, sot askujt nuk ia ndien nëse kërcënohen nga dikushi apo, më mirë të them, nga askushi për faktin se, sa më i lartë të jetë intensiteti i kërcënimeve, aq më e shkurtër do të jetë jeta e koalicionit qeverisës. Albin Kurti si Hudini po baraspeshon me këto kërcënime duke mbajtur një qëndrim më pajtues me opozitën, ndryshe do ta kemi gjendjen aktuale të Shqipërisë në Kosovë, madje me pasoja më të rënda. Shpresoj të mos jetë kjo vetëm një retorikë e Albinit që, për një periudhë të shkurtër "parakryeministrore", ka bërë më shumë takime se disa kryeministra gjatë mandatit të tyre. Dhe kryesisht po takohet me ata që më së shumti e kanë sulmuar dhe nuk e kanë përkrahur, me personalitete të deklasuara njerëzore, politike dhe kombëtare. Nuk keni nevojë t'i konsultoni arkivat e Stambollit, të Vjenës apo të Venedikut e të bindeni për këtë që e shkrova më lart. Mjafton ta rilexoni shtypin e disa viteve më parë! Ndërkombëtarët përfundimisht kanë vendosur ta eliminojnë nga skena politike krahun e luftës, por jo edhe njësinë paramilitare të Serbisë në Kosovë e quajtur dhe kamufluar si parti politike, Listën Serbe.

Axel Luta dhe shot-gun Albini: Lutfi Haziri është politikani legjendar i LDK-së i cili, në mënyrë stoike, heroike dhe historike ka përballuar çdo vështirësi, qoftë personale e që për të nuk ka qenë ndonjë problem për t'u përmendur, sidomos me sfidat me të cilat është ballafaquar LDK-ja për të cilën Axel Luta, si Feniksi shumë herë ishte bërë shkrumb dhe hi, por se gjithmonë ishte ringjallur dhe ringritur në hierarkinë e LDK-së. Kur kishte "kundërshtime" për koalicion me PDK-në, Luta thoshte se ky koalicion i përngjanë bendit "Gunns and Roses", ku PDK-ja ishte "Gunns" (pjesa e dhunshme), kurse "Roses", kush tjetër pos LDK-së. Por kjo nuk i pengonte aspak që të bëheshin bashkë në seanca të orgjive politike, ku secili partner e gjente interesin, qoftë për arsye ekskluzivisht institucionale, qoftë për materializim të luftës çlirimtare. Edhe në koalicionin e ardhshëm LV-LDK, Luta parasheh që Albini do të jetë përfaqësues politik i "Gunns"-ave, kurse Vjosa Osmani, përfaqësuese e trëndafilave apo "Roses". Në çdo kontekst dhe në çdo situatë apo koalicion, Luta dhe LDK-ja janë trëndafila e që në shumë raste kanë përfunduar edhe si karafila! Të vyshkur, pa asnjë dilemë! Perceptimi publik dhe personal mund t'ju ndihmojë ta sajoni një arsyetim që ju nxjerrë nga një situatë e çastit mirëpo, nëse ky perceptim përsëritet pas të gjitha zgjedhjeve, jo që nuk iu ndihmon, por krijon rrethana rënduese e që ua japin rolin inferior në çdo orgji politike të quajtur koalicion, prandaj LDK-ja gjithmonë e ka pësuar dhe është keqtrajtuar nga partnerët e koalicionit. LDK-ja duhet të lirohet nga virgjëria e ndershmërisë dhe drejtimi i akuzave drejt partive të tjera për kapje të shtetit për faktin se edhe vetë ka qenë pjesë aktive e kapjes së shtetit, hiç këtu kohën kur Ramush Haradinaj e përfundoi 50 për qind të mandatit si kryeministër. LDK-ja nuk do ta ketë aspak lehtë me LV-në, shumë do të sfidohet sidomos për bisedime me Serbinë. Janë dy botëkuptime krejtësisht të kundërta politike, prandaj do të ketë sfida e sfida, deri në fund të rrugëtimit, nëse do të ketë kondicion të mjaftueshëm për këtë rrugëtim, me asnjë të panjohur dhe me epilogun e njohur dhe të imponuar, arritja e marrëveshjes me Serbinë që, për bindjen time, edhe është e shkruar dhe vetëm duhet të nënshkruhet.

Arkitektura qeverisëse e koalicionit LV-LDK: Albin Kurti ende po flet si përfaqësues i opozitës derisa të ulet në postin që ua ka djegur prapanicën politike të gjithë kryeministrave të mëparshëm. Ka qëndrim të fortë për dialog me Serbinë dhe, nëse vetëm 50 për qind të këtyre premtimeve i materializon politikisht, do të bëhet kryeministri më i përkrahur në Kosovë. Me Listën Serbe po luan koç... për faktin se ajo mund të defaktorizohet, por le të harrojë se me këtë Kushtetutë të Ahtisarit do ta bëjë ministër Nenad Rashiqin apo Slloben, kurse do t'i dërgojë në "recycle been" serbët e Aleksandar Vuçiqit dhe Goran Rakiqit. Albin Kurti do të ishte më mirë që serbët që janë integruar në institucione të Kosovës e që në mënyrë kriminale janë eliminuar nga Lista Serbe, Aleksandar Vuçiqi, disa ndërkombëtarë konformistë dhe politikanë të kriminalizuar kosovarë, të krijojë kushte që të udhëheqin ndonjë agjenci apo ta kenë ndonjë vend pune ku do të kishin mundësi të kontribuojnë për komunitetin e tyre me ç'rast do të rritej edhe fuqia elektorale.

E mira e këtyre zgjedhjeve është se ka përfunduar me sukses procesi i deratizimit politik, me ç'rast janë eliminuar nga skena politike kosovare shumë minj të tokës dhe nëntokës dhe brejtës të tjerë që kanë dëmtuar dhe infektuar çdo gjë në këtë vend duke e turpëruar Kosovën dhe qytetarët e saj në tërë botën, madje edhe në Afrikë. Është larguar ndryshku njerëzor dhe moral me një proces lavazhi të pjesërishëm. E keqja e kësaj situate është se si shumë po përmenden burgjet pikërisht nga ata që shumë më herët është dashur të vendosen në burgje.

Është e pabesueshme lehtësia me të cilën po kërcënohen me burgje dhe hakmarrje dhe për këtë Albin Kurti duhet të ketë me vete qetësues për një numër të falangistëve që kërcënojnë, në emër të Albinit dhe LV-së sikur edhe qeverisë, e cila ende nuk është formuar. Po harrojnë se ne kohën kur tomisllavët e Serbisë dhe të Jugosllavisë na e mohonin lirinë të cilët tomisllavët e sotëm e konsideronin si liri, nuk kishim asnjë problem të futemi në burgje apo të bëjmë çdo sakrificë që kërkohej nga ne, por që frytet e kësaj sakrifice po e gëzojnë sot kryesisht mohuesit e lirisë dhe bashkëpunëtorët e mohuesve të lirisë. Nëse ne u detyruam ta vazhdojmë rrugën e prindërve tanë për ta jetësuar ëndrrën dhe këngën e tyre të lirisë, pa asnjë dyshim këtë do ta bëjnë edhe fëmijët tanë sepse janë edukuar në këtë frymë. Lirinë ende nuk e kemi të plotë, për shtet as mos të flasim. Nuk është shtet kur 20 vjet pas përfundimit të luftës jeni të kufizuar të lëvizni lirisht nëpër vendet e botës së lirë. Nuk është shtet ky kur detyroheni të bisedoni për realizimin e kësaj lirie të lëvizjes duke ofruar dhe pranuar bisedime për koncesione materiale. Nuk është shtet i mirëfilltë nëse shteti që ka shkaktuar aq shumë vuajtje, dëme dhe që ka bërë krime në Kosovë, me ndihmën e ndërkombëtarëve dhe donkishotëve kosovarë bëhet aksionarë me të drejtë pronësie në tokat e Kosovës dhe proceset politike të Kosovës. Është zbehje e tërë situata kur detyroheni ta pranoni dhe votoni, në kushte të terrorizimit, një Gjykatë Speciale që ndjek viktimat kurse falë kriminelët. Nuk ka ndonjë kuptim shteti ku paragjykimi në baza fetare është përcaktues për ardhmërinë politike, ekonomike etj.

Pas këtyre zgjedhjeve kemi një standard apo disa standarde që kanë munguar më herët nga opozita; pastrimi i listave nga të korruptuarit e që autorësinë e ka te Kadri Veseli dhe pranimin e rezultatit të zgjedhjeve e që bashkautorë janë Ramush Haradinaj dhe Kadri Veseli. Asnjëherë më parë nuk kemi pasur situata kur ka pasur deklarime aq të shpejta dhe aq të vendosura për pranim të rezultateve nga opozita dhe zotim se do të jenë opozitë konstruktive në të gjitha proceset nëpër të cilat do të kalojë Kosova. Ky qëndrim i opozitës, nëse nuk ndryshon në ndërkohë, do ta margjinalizojë krejtësisht Listën Serbe andaj pozita duhet ta vlerësojë këtë.

Albin Kurti e ka shtrirë kosën pak si gjerë; po premton reforma në drejtësi, polici, shëndetësi, arsim, ekonomi etj. Sikur të gjithë opozitarët para se të vishen me pushtet. Krejt këto premtime tingëllojnë bukur për veshin e dhunuar të qytetarit të Kosovës por, në rrethana aktuale, është vështirë të materializohen, së paku në masën e premtuar. Problemi kryesor është Serbia dhe nuk do të ketë përparime në asnjë fushë derisa të eliminohet ky problem. Serbisë nuk i intereson se a kanë serbët e Kosovës të drejta (kanë madje më shumë se vetë shqiptarët që përbëjnë 93 për qind të popullatës e mos të flasim për pakicat e tjera që në raport me serbët diskriminohen brutalisht). Serbisë nuk i interesojnë serbët e Kosovës, por i intereson territori i Kosovës, prandaj deklaron se nuk ka njohje të Kosovës në kufijtë aktualë. Ndërkombëtarët, përjashtuar Gjermaninë, janë të gatshëm ta përkrahin Serbinë në riokupim të territorit të Kosovës të ambalazhuar si marrëveshje detyruese për të gjitha palët e që do të nënshkruhej në oborrin e Shtëpisë së Bardhë në Uashington, në prani të presidentit Tramp i cili po shërben si katalizator i proceseve politike në Kosovë e që nuk kam asnjë dyshim do ta lënë Kosovën pa një pjesë të territorit të saj. Nuk është ndërrimi i territoreve ide e Hashim Thaçit - Shimës, por se atij i është imponuar. Nuk e di nëse do ta pranonte, por jam i sigurt se Ramush Haradinaj, duke e penguar përkohësisht këtë proces, e ka ngadalësuar një gjendje faktike siç ishte ndërrimi i territoreve. Kosova është deklaruar se nuk ka aspirata territoriale ndaj asnjë shteti e që e ka futur si kategori kushtetuese, prandaj është më mirë edhe një herë nëse është e pashmangshme të hyjë në një luftë të re me Serbinë sesa vullnetarisht ta japë edhe një milimetër të vetëm të territorit aktual. Nëse Albin Kurti me Vjosa Osmanin arrijnë ta mbrojnë integritetin territorial të Kosovës atëherë mund, me të drejtë të thuhet, se Kosova po shkon drejt stabilizimit. Nëse Kosovës i merret edhe një milimetër i vetëm i territorit aktual atëherë nuk mund të thuhet ndryshe, përveçse Kosova po shkon drejt shthurjes, si vend, si shtet dhe si popull! Në mbrojtje të integritetit territorial të Kosovës opozita duhet të sillet më pozitë se vet pozita duke e përkrahur 100 për qind. Në Kosovë më herët flitej për lozhën e masonëve apo muratorëve të lirë dhe në çdo kontekst përmendeshin emrat e Veton Surroit dhe Blerim Shalës si masonë. Gjithashtu, flitej se arkitektë të politikës dhe politikave në Kosovë janë Veton Surroi, që qëndron prapa Albin Kurtit - "Mr. Beanit" dhe Blerim Shala që qëndron prapa Hashim Thaçit - Shimës. As nuk e pohoj e as nuk e mohoj! Por, disi po besoj se këto bisedime me Serbinë do të jenë shumë të kushtueshme për Kosovën dhe se nuk do të ndahemi mirë. Aspak nuk i besoj Donald Trampit se është qëllimmirë në këto bisedime sepse disi si shumë po ngutet. Filozofia e popullit qartë thotë se: "kush ngutet, do të përmutet ..." Qofsha i gabuar!

Në 30-vjetorin e rënies së Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut (2)

# Zhvillime të pas kryengritjes në Kosovë dhe roli i Afrim Zhitisë e Fahri Fazliut në LKSH



Shkruan: Mehmet HAJRIZI

**1.** Nga fjala ne vepër, thoshte Tito dikur. Që nga viti 1981 dhe deri më 1984, kur më 11 janar bien heroikisht dy korifenjtë e shquar të LKSH, Rexhep Malaj e Nuhi Berisha dhe vetëm një muaj pas, më 8 shkurt edhe veprimtari Bajram Bahtiri, kurse më 14 të po këtij muaji arrestohet heroi i ardhshëm, Afrim Zhitia, sipas shënimeve zyrtare, u dënuan penalisht katër mijë veta për veprimtari çlirimtare në Kosovë. Le të shtojmë këtu që brenda viteve 1981-1990 në Kosovë policia dhe ushtria jugosllave kanë vrarë 183 shqiptarë (prej tyre 16 fëmijë) dhe kanë plagosur me armë zjarri 616 të tjerë.[1] Për demonstratat e vitit 1981 janë shqiptuar më shumë se 50 shekuj burg për qytetarët e Kosovës.

Një fushatë sulmesh të egra, të denja për mesjetën, u organizua kundër kulturës, historisë, arsimit, inteligjencies dhe çdo vlere shqiptare.

**2.** Përballë këtij terrori, LKSH nuk u mposht as nuk u ndal. OMLK[2] qysh gjatë kryengritjes kishte hartuar në maj të vitit 1981 një dokument programatik për formimin e një fronti të përbashkët të të gjitha subjekteve të LKSH dhe qytetarëve të tjerë patriotë, me titull "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës".[3]

Në vitin 1982 u arrit bashkimi i disa organizatave në një front të quajtur "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi", e cila veproi suksesshëm me emërtimet LPRK (Lëvizja për Republikën e Kosovës" dhe më vonë LPK (Lëvizja Popullore e Kosovës). Kjo organizatë, e shtrirë brenda dhe jashtë vendit e me përvojë të gjatë, botonte vite me radhë organin "Zëri i Kosovës" dhe njihet si themeluese e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lufta e së cilës edhe me mbështetjen ndërkombëtare i dha fund sundimit serb e jugosllav në Kosovë. Afrim Zhitia që në vitin 1980, bashkë me një grup të rinjsh kishte filluar të vepronte në kuadrin e OMLK-së, për të qenë pastaj bashkë me Fahri Fazliun në frontin LRSHJ dhe LPRK.

**3.** Pas vitit 1981 Lëvizja e goditur rëndë, u ripërtëri dhe u rimëkëmb, jo nga e para, por mbi bazën e strukturave të ndërtuara organizative dhe të përvojës së pasur të deriatëhershme. Brenda në Kosovë po vepronin, përveç LPRK edhe shumë organizata të tjera, si vazhdimësi e organizimit më të hershëm, ose si themelime të reja.

Pas GRK-së së themeluar në fillim të viteve shtatëdhjetë, në periudhat vijuese para dhe pas kryengritjes më 1981, janë formuar edhe shumë organizata të tjera çlirimtare, si Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ), Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi (PKMLSHJ), Lëvizja për Çlirim Nacional dhe Social e Kosovës (LÇNSK), Fronti i Kuq Popullor (FKP), ALBANIKOS, Partia e Luftës e Kosovës (PLK), Fronti Nacional-Çlirimtar (FNÇ), Kushtrimi i Lirisë (në Maqedoni), Marksistë-Leninistët e Kosovës, (MLK), OMLK e riformuar, Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) e shumë të tjera të formuara brenda dhe jashtë vendit.

**4.** LKSH e kësaj dekade kishte si mjet veprimi edhe një shtyp klandestin të admirueshëm dhe të larmishëm. Praktika e shtypit klaandestin kishte filluar më 1974 nga Grupi Revolucionar i Kosovës, me revistën „Zëri i Kosovës", për t'u pasuruar shpejt edhe me një varg organesh të shtypit, trakte politike, thirrje dhe komunikata, botime të veçanta etj., të cilat i jepnin zë LKSH dhe siguronin komunikimin më adekuat midis saj dhe publikut të brendshëm e të huaj. Gjurmë të pashlyshme në historinë e gazetarisë dhe publicistikës shqiptare kanë lënë organet e shtypit klandestin të LKSH, si Liria, Lajmëtari i Lirisë, Bashkimi, Revolucioni, Zëri i Atdheut, kurs nga viti 1982 LRSHJ-LPK gjatë gjithë dekadës e botoi organin Zëri i Kosovës në qindra numra dhe dhjetëra mijë ekzemplarë. Organe të tjera dhe buletine të shumta ishin edhe Rruga e Lirisë (Afrim Zhitia, Fadil Vata, Fahri Fazliu), Minatori, Pararoja, Kushtrimi i lirisë, Informatori, Çlirimi dhe dhjetëra të tjerë. Ndërkaq, gjatë viteve tetëdhjetë, LPRK ngriti tetë radio lokale në mërgatë.[4]

Në Lëvizjen Kombëtare të Kosovës gjatë kësaj periudhe, shtypi klandestin dhe botimet e veçanta u bënë mjet i pazëvendësueshëm për përhapjen e ideve të lirisë, demaskimin e politikës shtypëse e shfrytëzuese të regjimit pushtues në Kosovë dhe informimin objektiv të qytetarëve e zgjimin kombëtar shqiptar. Nëpërmjet të shtypit të saj, Lëvizja Kombëtare Shqiptare i mbronte e kultivonte vlerat e traditës luftarake shqiptare, edukonte atdhedashurinë, frymën e sakrificës, trimërinë e virtyte tjera të larta njerëzore e kombëtare.

**5.** Afrim Zhitia më 1984 ishte arrestuar si pjesëtar i Fronti Nacional-Çlirimtar (FNÇ), për t'u dënuar në moshë të njomë, me tetë vjet burg, nga të cilat i mbajti katër.




Pas katër viteve burgimi, ai më 1988 kthehet në Kosovë, tashmë i formuar si drejtues profesionist dhe revolucionar. Me të dalë nga burgu i gjeti shokët e tij në krye të detyrës. Fahri Fazliu që ishte shumë aktiv në këtë periudhë vuri kontakt me Afrimin, ngjashëm siç ishin lidhur për të mos u ndarë kurrë edhe heronjtë Rexhep Malaj e Nuhi Berisha, më 1983. Regjimi e kishte arrestuar Afrimin në shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe fill pas burgut e ktheu përsëri atje, por duke pasur parasysh zhvillimet dramatike në Kosovë, ai arratiset dhe kalon në konspiracion të thellë. Afrimi në burg ishte i vetëdijshëm se pas mbarimit të dënimit, nuk do t'i kthehej jetës së qytetarit të rëndomtë dhe punës për mbijetesë, por frontit të hapur, sepse atje do t'i gjente shokët e vet në llogoret e tij.

**6.** Gjatë viteve 1988-1989 veprimtarët më të dalluar në Kosovë që praktikisht e morën drejtimin e LPRK-së ishin: Fadil Vata, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Ahmet Haxhiu, Ali Ajeti, Bedri Sokoli etj. Fahriu dhe Afrimi u angazhuan me tërë kapacitetin e tyre për zgjerimin e radhëve të Lëvizjes dhe forcimin organizativ të saj. Ata vepronin pareshtur në terren, duke formuar këshillat popullorë, si në Ferizaj, Lipjan, Podujevë, Gjilan, në Maqedoni e Mal të Zi etj.[5]

Fahri Fazliu, ose Fatmiri, siç e quanin zakonisht, shquhej më shumë për organizim dhe veprimtarinë e kishte shtrirë edhe jashtë vendit, që nga Zagrebi deri në Bukuresht.[6] Fahriu nuk shkruante shumë, siç bënte Afrimi, por janë të njohura tri pikëpamje të tij për çlirimin e Kosovës. Në përputhje me zhvillimet demokratizuese në rajon, ai paraqiste strategjinë e tij në dy shtylla: Ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare dhe zgjidhjen eventuale të saj në rrugë paqësore, nëpërmjet të një referendumi, në të cilin do të deklarohej vullneti i shqiptarëve për të jetuar të lirë dhe të pavarur. Por, në rast se nuk do të arrihej çlirimi me mjete paqësore, ai kishte pikëpamjen e tretë të zgjidhjes së nyjës, me kryengritje të armatosur.[7]

**7.** Fundi i viteve tetëdhjetë e kishte acaruar gjendjen, jo vetëm në Kosovë, por në gjithë rajonin. Kampi socialist po shembej si gurët e dominos. Në këtë proces në Evropën Lindore, diku nëpërmjet të tronditjeve të fuqishme, e diku më qetë, shtetet ish-socialiste, si Polonia, Çekosllovakia, Rumania, Hungaria, RD e Gjermanisë (1989), BRSS, Shqipëria, Bullgaria (1990) etj., po transformoheshin me shpejtësi, duke humbur partitë komuniste rolin e tyre hegjemon dhe vetë sistemin monist. Pati dhe ngjarje të tjera historike që ndikuan fuqishëm në zhvillimet botërore të fund dekadës së nëntë të shekullit të kaluar, si shembja e Murit të Berlinit, tërheqja e trupave sovjetike nga Afganistani dhe e trupave vietnameze nga Kamboxhia (1989), bashkimi i Gjermanisë etj. Vetëm një javë pas rënies së Afrimit dhe Fahriut, më 9 nëntor 1989 u shemb muri i Berlinit.

Rajoni karakterizohej nga lufta për çlirim nga ideologjia komuniste dhe totalitarizmi, por popujt me të drejtat e mohuara kombëtare, përpjekjet i drejtonin më parë për pavarësinë kombëtare, shtetin nacional dhe sovranitetin.

Diktatori serb, Millosheviq që në fakt e kishte shpallur luftën ekspansioniste, i dha erë baroti gjithë Federatës jugosllave.

***(Vijon)***

*[1] Dr. Pajazit Nushi, Fenomenologjia e dhunës ushtarake-policore në Kosovë në vitet 1981-1992, Tiranë, 1996 f. 283, 285. Cituar sipas Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Organizata dhe grupe ilegale në Kosovë 1981-1989, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003, f.40.*

*[2] Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës, e cila po vepronte 12 vjet rresht, fillimisht si Grupi Revolucionar i Kosovës, mbi bazën e një oragnizimi të ri, me disiplinë dhe konspiracion të rreptë, me radhët e zgjeruara gjithandej trevave shqiptare të pushtuara nga Serbia e Jugosllavia, me shtypin e saj klandestin, sidomos me „Liria"-n e mirënjohur etj.*

*[3] Arkivi i Kosovës*

*[4] Emrush Xhemajli, Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002, 20 vjet veprimtari, shkurt 2002*

*[5] „Zëri i Kosovës", nr. 5, mars 1991, f. 6*

*[6] Po aty.*

*[7] „Zëri i Kosovës", nr. 5, mars 1991, f. 6*

E rrallë

# Avioni bie në zonë të banuar, marrin flakë shtëpitë



Një avion është rrëzuar në një zonë të banuar të Nju Xhersit, duke ua vënë flakën dy shtëpive. Administrata Federale e Aviacionit Amerik dhe Bordi i Sigurisë së Transportit Kombëtar në ShBA janë duke hetuar përplasjen. Pamjet e dala deri tani duken të tmerrshme. Ende nuk dihet numri i saktë i viktimave, por dy shtëpitë ishin bosh në kohën e aksidentit.

FOTO E DITES




Ekipet e zjarrit ecin përgjatë një kreshte të shkrumbuar si pasojë e zjarrit në Los Anxhelos. /AP/

E jashtëzakonshme

# Tigri me dhëmbët prej ari



Cara, një tigër gjashtëvjeçare, tashmë gëzon një dhëmbë prej floriri, pas një operacioni të ndërlikuar që zgjati plot 80 minuta, në Gjermani. Cara u konfiskua dhe u dërgua në një fermë në Mugnano të Italisë në vitin 2013 dhe më pas u transferua në stacionin e tigrave në 2015-n në Gjermani. Një ekip ekspertësh ndërkombëtarë përgatitën një kurorë ari për Caran dhe ajo iu nënshtrua dy operacioneve të ndërlikuara për ta shpëtuar kafshimin e saj dhe për t'i parandaluar vuajtjet e mëtejshme, ndërsa përpiqej të hante.

## BARSOLETA E DITËS



Rrugë e gjatë, nxehtë i madh, para tyre ndodhet një pemë dhe ata bashkë vendosin të ulen nën të. Pas një kohe gruaja çon kokën lart, sheh dy zogj sqep me sqep dhe i thotë të shoqit:
- More burrë, çfarë po bëjnë ata zogj atje lart?
- Po puthen.
- Po pse nuk më puth edhe ti mua?
- Po kush dreqin hip atje lart!

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

**ABOMINABLE 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton







Çdo ditë në ora 16:00

**TOY STORY 4 / 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley

Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

**MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D**

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning







Çdo ditë në ora 22:00

**ZOMBIELAND DOUBLE TAP**

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sjellja juaj bujare inspiron dhe është e mirëpritur nga të tjerët, gjithashtu ka nga ata njerëz që e konsiderojnë sjelljen tuaj si arrogante.



**DEMI**
Ndërkohë që ju po shijoni suksesin, do të ndodhë diçka që do t'ju bëjë të ndiheni keq rreth kësaj.



**BINJAKËT**
Për ta ruajtur paqen dhe harmoninë mund të shtireni. Kujdes, se shtirja juaj mund të zbulohet.



**GAFORRJA**
Detyra juaj e re në rrugën e suksesit mund të jetë një pilulë e vështirë për t'u gëlltitur.



**LUANI**
Mungesa e marrjes së vendimeve mund t'ju plagosë. Ju jeni person i përgjegjshëm.



**VIRGJËRESHA**
Ju mund të ndiheni sikur po bëni të gjithë punën në një projekt apo marrëdhënie. Dhe nëse e lini pas dore për një minutë, e gjitha do të fundoset.



**PESHORJA**
Është e rëndësishme të jeni fleksibël, por jo aq shumë sa të mos merrni dot vendime për asgjë.



**AKREPI**
Ju ndiheni të fortë emocionalisht, edhe pse disa njerëz mund të ndërhyjnë në planet tuaja.



**SHIGJETARI**
Mund të ndieni se një përgjegjësi e madhe po pret për ju, por mendja juaj është shumë e trazuar për të përfituar nga ajo.



**BRICJAPI**
Natyra juaj e ndjeshme është tërheqëse. Kjo mund të bëjë që sot të jeni të mërzitur.



**UJORI**
Ndiheni sikur po ecni me një tren të shpejtë drejt suksesit, por suksesi mund të arrihet në mënyra të ndryshme.



**PESHQIT**
Mund të ndiheni si një kërmill që del nga guaska e tij.

# Ndahen Megi dhe Johni



Pasi kaluan tetë vjet bashkë, Meg Ryan dhe John Mellencamp i dhanë fund fejesës së tyre. "Ajo kaloi mjaft dhe i dha fund fejesës", ka treguar një burim për "Us Weekly" për aktoren 57-vjeçare. "Ajo nuk ndien keqardhje", vazhdoi më tej burimi. Meg kohët e fundit ka folur për jetën e saj të dashurisë dhe jo shumë kohë më parë ajo tha se po shpresonte të martohej së shpejti. Çifti fillimisht njoftoi fejesën në nëntor të vitit 2018.

# Kylie si "lepurushe"





Kylie nuk njeh limite për Halloweenin. Në çdo festë, miliarderja 22-vjeçare shfaqet me një look të ri. Të martën në mbrëmje ylli i realiti shout është veshur si "lepurushe" e "Playboy"-it. Jenneri ka postuar një video të shkurtër në "Instastory" ku dukej tepër seksi.



# Selena Gomezi punoi katër vjet për albumin e ri

Selena Gomezi bëri një fytyrë qesharake kur u takua me disa fansa jashtë një hoteli në Nju Jork. Këngëtarja 27-vjeçare ishte rrugës për një intervistë për të folur për këngët e veta të reja. Selena foli për albumin e saj të ri për të cilin u deshën katër vjet. "Unë kam punuar në album për katër vjet. Nuk doja të lëshoja ndonjë gjë pa e ndjerë, se ishte koha e duhur. Kam mësuar shumë nga albumi i fundit dhe atë kam dashur ta shndërroj në diçka të mirë", ka thënë ajo.

# Adele tregon sekretin e dietës që e dobësoi kaq shumë





Këngëtarja e famshme Adele po i nxjerr "si me grep" sekretet e dobësimit të saj. Ajo ka humbur mjaft peshë dhe u tha se ajo është kthyer në një adhuruese të Pilatesit, i cili e ka ndihmuar shumë të heqë ca nga kilogramët e tepërta. Por nuk qenka vetëm kaq: pamja mbresëlënëse e saj në festën e datëlindjes së 33-të të reperit Drake e cila u mbajt në studiot e Goya në Hollywood, duket i detyrohet dhe një diete të cilën e ka ndarë edhe me ndjekësit e vet.

# Kur Marksi i dhuronte një këngë



Nga: Nasho JORGAQI

Është për nderin tonë që në jetën dhe në veprën e Karl Marksit (Marx) të gjenden mendime e të dhëna që lidhen me Shqipërinë e botën shqiptare. Ato, ndonëse janë anësore në shumanshmërinë e trashëgimisë së tij, prapë duhen njohur e studiuar.

Interesimin e Marksit për historinë dhe për karakterin e popullit shqiptar e ndeshim qysh herët. Në vitet e rinisë, gjatë përpjekjeve që bënte për formimin e tij shkencor, ai do të studionte e konspektonte historinë e disa vendeve, duke filluar nga historia e Francës e deri te "Historia botërore" e Shloserit.

Rëndësi të veçantë për ne kanë shënimet e nxjerra nga studimi i historisë së Perandorisë Osmane. Në to ai përmend shqiptarët dhe flet me simpati e vërtetësi për ta. "Midis kombeve të tjera, – shkruan Marksi i ri, – po ndalemi para së gjithash tek shqiptarët. Ky është një popull trim malësor, i cili përbën popullsinë autoktone të vendit që shtrihet në shpatet e brigjeve të Adriatikut; ai flet gjuhën e tij të veçantë që bën pjesë në familjen e madhe të gjuhëve indoeuropiane".

Në historinë shqiptare vëmendjen e Marksit e tërheqin në radhë të parë epoka e luftërave të Skënderbeut dhe personaliteti i tij. Për të, vepra e Heroit tonë Kombëtar i ka shërbyer objektivisht progresit të njerëzimit. Duke e vlerësuar lart luftën antiosmane të popullit shqiptar, ai e cilëson atë si "një goditje kundër të vetmit shtet me të vërtetë ushtarak të mesjetës, i cili i kundërvihej zhvillimit historik që po lindte dhe përparimit botëror".

Qëllimi ynë në këtë artikull nuk është hulumtimi e studimi tërësor i trashëgimisë së Marksit, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthor me Shqipërinë dhe me historinë e popullit shqiptar.

Është fjala për një album folklorik të përgatitur nga vetë Marksi në kohën e rinisë.

Albumi, siç do ta shohim më poshtë, nuk u hartua me qëllim botimi dhe mbeti në mes të dorëshkrimeve të tjera. Për herë të parë ai u botua më 1929 në Berlin në serinë e veprave të plota të Marksit dhe të Engelsit (Karl Marx, Friedrich Engels, Gesamtansgube – Mega – ), në vëllimin e parë: Karl Marks, Vepra: Artikuj, sprova letrare deri në mars 1843. Tekste. (Karl Marx – Werke, Artikull Literarische Versuche Bis März 1843. Text).

Albumi është një koleksion këngësh popullore të popujve të ndryshëm, të cilat Marksi i përmbledh enkas dhe ia dhuron më 1839 të fejuarës së tij Zheni Vestfalen në Berlin. Në krye ai ka këtë kushtim: "Këngë popullore gjermane (në të gjitha të folmet), spanjolle, greke, letone, estone, shqiptare etj.) të mbledhura e të kopjuara nga përmbledhje të ndryshme për Zhenin tim të shtrenjtë. K. Marks, Berlin 1839".

Ky ishte albumi i dytë që Marksi i ri i dhuronte Zhenit, pas koleksionit të parë të shkruar me dorën e tij nën titullin: "Një përmbledhje me këngë e legjenda të vjetra gjermane".

Fillimisht ne njohëm nga albumi vetëm kushtimin. Vëmendjen tonë e tërhoqi fakti se aty përfshiheshin edhe këngë popullore shqiptare.

Por më vonë, duke hulumtuar në trashëgiminë e K. Marksit, ramë në gjurmët e albumit dhe e gjetëm të botuar në veprën e tij të plotë. Njohja e drejtpërdrejtë me të, jo vetëm zgjidhi përfundimisht hamendjet tona, por na lejon ta shqyrtojmë nga afër e ta gjykojmë më saktë përmbledhjen, kriteret e zgjedhjes, vendin që zë kënga popullore shqiptare në të.

Albumi përmban gjithsej 80 këngë popullore, të ndara në 9 grupe: këngë gjermane, këngë spanjolle, këngë estoneze, këngë të vjetra greke, këngë të reja greke, këngë laplande, këngë letone, këngë italiane dhe këngë finlandeze.

Kënga shqiptare është vendosur më vete në grupin e gjashtë dhe, megjithëse jepet përkatësia kombëtare, ajo përfshihet si këngë në greqishten e re. Një pikëpamje e tillë ishte zotëruese në studimet gjuhësore të kohës, pasi deri në vitet '60 të shekullit të kaluar, gjuha shqipe vendosej në një grup gjuhësor me greqishten e vjetër dhe latinishten. Po pavarësisht nga kjo hollësi formale në renditjen e këngës, përmbledhësi është i ndërgjegjshëm se ajo i takon folklorit të popullit shqiptar.

Albumi përbëhet në radhë të parë nga këngë popullore lirike, nga legjenda, balada, këngë humoristike, epigrafe. Aty gjejmë dhe disa këngë nga poezia e kultivuar, që siç duket kanë qenë dhe të popullarizuara, si nga Safo e ndonjë tjetër. Kryesisht mbizotëron motive i dashurisë.

Vetvetiu, kur lexon albumin, lindin një varg pyetjesh e problemesh që kanë të bëjnë me arsyet që e shtynë Marksin të përgatisë këtë përmbledhje, me burimet që shfrytëzoi dhe me kohën e tij.

Por para se t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve, le të njohim prirjet dhe interesat e djaloshit gjenial në vitet e rinisë së hershme. Siç kanë vërejtur biografët e tij, Marksi në këto vite është marrë me krijimtari letrare. Madje, sipas tyre, disa nga idetë e filozofit të ardhshëm fillimisht u shfaqën nëpërmjet imazheve poetike. Kështu, Oulanemi, heroi i tragjedisë së tij omonime, lindi duke u përftuar nga një ide e rëndësishme, të cilën autori më vonë do ta shprehë me fjalët e filozofit "në çdo gjë abstrakte ka një gjë konkrete".

Në vitet e para të rinisë, për një kohë, Marksi u dha seriozisht pas letërsisë. Shkroi vjersha e poema, u mor dhe me prozë, nisi një tragjedi, përgatiti dhe një vëllim poetik për botim, të cilin ia kushtoi të atit (1837). Por dashuria e tij për letërsinë nuk zgjati shumë, ai u nda shpejt prej saj. Për këtë ndikoi i ati, po më shumë e kuptoi vetë, sepse, siç i pohonte në një letër babait, ai "nuk do të ishte kurrë një poet i vërtetë" dhe "do të pushonte së shkruari gjëra të tilla, gjë që deri më sot nuk e kish bërë dot".

Pas kësaj Marksi "gjithë forcën e kritikës së tij e drejtoi kundër krijimeve të muzës së vet". Me sa duket, prirjet krijuese të djaloshit nuk kishin të bënin në thelb me letërsinë artistike, por me disa sfera më të gjera e më të thella. Dhe vërtetë, Marksi në moshën 18-vjeçare e la përfundimisht letërsinë.

Por, në qoftë se nuk shkroi letërsi, kjo nuk do të thotë se u shkëput prej saj. Në një kuptim më të gjerë, ai do të mbetet i lidhur me krijimtarinë artistike. Marksi do të bëhet një krijues gjenial dhe sipas F. Meringut, një nga stilistët më të fortë të letërsisë gjermane.

Kalimi i interesave të Marksit nga krijimtaria e tij origjinale në krijimtarinë popullore ndodhi pikërisht në kohën kur ai vendosi të mos merrej më me letërsi. Vjershat që kish shkruar, i qenë kushtuar në pjesën më të madhe dashurisë për Zhenin. Por kur hoqi dorë përfundimisht prej muzës poetike, ai kërkoi që dashurinë e tij ta shfaqte përmes folklorit. Kështu, gjuha e thjeshtë e poezisë së popullit u bë gjuha me të cilën ai do t'i shprehte Zhenit ndjenjat e veta të fuqishme. Nga ana tjetër, kjo mënyrë e re u përgjigjej dhe dëshirave e kërkesave shpirtërore e intelektuale të Zhenit, mbasi ajo ishte e dashurar pas këngës popullore.

Interesimi i Marksit për folklorin ndodhte në klimën romantike, kur idetë e këtij drejtimi përbënin një nga prirjet kryesore të kohës. Gjermania e këtyre viteve ishte bërë atdheu i kësaj lëvizjeje shoqërore e letrare. Që në shekullin XVIII J.G. Herderi kishte mbrojtur pikëpamjen sipas së cilës kultura popullore vështrohej si pjesë e rëndësishme e kulturës kombëtare. Botimi prej tij i antologjisë universale "Zëri i popujve në këngë" (1778-79) kishte zgjuar interesimin e njerëzve e sidomos të intelektualëve për folklorin.

Në vitet '30 të shekullit XIX, kur shoqëria gjermane ishte para rev-

# shqiptare të dashurës së tij



olucionit demokratiko-borgjez, mjaft nga poetët e lidhën poezinë e tyre me idetë romantike e me frymën popullore, duke shkruar në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për masat. Vetë Gëtja do të shkruante një varg poezish me motive nga folklori oriental, disa prej të cilave kanë motive të popujve të Ballkanit.
Marksi e përjetoi atmosferën e shëndoshë të romantizmit. Ai ishte bashkëkohës i vëllezërve Shlegel, teoricienëve të këtij drejtimi. Idetë romantike të lirisë po i shërbenin zgjimit kombëtar të popujve dhe luftës së tyre për pavarësi. Ditadités krijimtaria popullore po njihej më mirë nga një varg botimesh. Marksi i ri, që prirej shpirtërisht nga dukuritë e reja, nuk mund të qëndronte larg ideve e koncepteve novatore të romantizmit. Ai do t'i bënte për vete e do të ushqehej me letërsinë burimore të popullit.
Sipas Engelsit "Marksi adhuronte bukurinë e jashtëzakonshme të poezisë së lashtë të popullit" dhe që nga viti 1834 do të shpallte si moto të vetën fjalët: "Lumturia jonë do t'u përkasë milionave".
Marksi me Zhenin, përveç ndjenjës së përbashkët, kishin dhe mendime e koncepte të njëjta për jetën dhe shoqërinë. Kjo dukej fare qartë në adhurimin e thellë që kishin për folklorin e përgjithësisht për kulturën popullore. Zheni, nga ana e saj, kishte lidhje me rrethet letrare që udhëhiqnin lëvizjen e romantizmit në Gjermani. Ajo ishte shoqe me Betina Arnimin, e njohur për korrespondencën me Gëten dhe për idetë e krijimtarinë romantike. L.M. Bretano dhe H.A. Arnimi kishin botuar përmbledhjen tjetër folklorike "Briri magjik i djalit".
Marksi kishte miqësi me folkloristin gjerman Karl Frederik Kopensin, i cili në këto vite merrej me mitologjinë nordike dhe me runet (këngë finlandeze).
Kështu, në atmosferën e frymës së romantizmit të përhapur në Gjermani, te Marksi dhe Zheni po lindte shpirti herderian. Një shpirt i tillë kishte të bënte jo vetëm me adhurimin e folklorit dhe çdo gjëje popullore, po dhe me konceptimin e drejtë të krijimtarisë orale. Marksi do ta tregojë shpirtin herderian me punën konkrete që bën për hartimin e albumit folklorik.
Duke ndjekur parimet e Herderit, ai e vështron poezinë anonime si pasqyrë të ndërgjegjes popullore, si dëshmi të jetës së njerëzve të thjeshtë dhe model të thjeshtësisë. Nga ana tjetër, ai ka parasysh kriteret e Herderit edhe në hartimin dhe strukturën e albumit, duke i ndarë këngët sipas popujve dhe këngët gjermane sipas krahinave.
Lëndën poetike që Marksi e përfshiu në këtë album, nuk e voli nga burime origjinale, po nga botime folklorike të kohës. Në këtë punë i erdhi në ndihmë miku i tij, folkloristi K.F. Kopensi, qoftë me runet e botuara, qoftë me të dhëna të tjera të drejtëpërdrejta. Në zgjedhjen e koleksionit të poezive që do t'i dërgonte Zhenit, Marksi nuk u mbështet në përmbledhjet e njohura folklorike. Ai shfrytëzoi në radhë të parë botimet më pak të njohura si ato të Hofmanit, Hipelit, Bajronit, Agrumit, Shroterit e sidomos burime të kohëve më të reja si "Fletoret" e Kreçmerit (1838-39). Më shumë mori nga përmbledhja e Eslahut, botuar në vitet 1834-36, disa nga Xukalmalio. Një vend të nderuar zuri Herderi, si ati i folkloristikës gjermane.
Sipas studimeve të bëra, vihet re se një pjesë e këngëve nuk janë ruajtur si në origjinal, po janë prekur nga mbledhësit. Ndryshime do t'u sjellë atyre dhe Marksi, qoftë duke i ridhënë me fjalë të tjera, qoftë duke ndryshuar radhët e strofave ose duke zëvendësuar emrat me emrin e tij e me atë të Zhenit.
Nuk duhet të harrojmë se përmbledhja nuk u përgatit me qëllim botimi, po si një album që i drejtohej një të afërmi intim, siç ishte e fejuara. Prej kësaj vjen dhe ajo liri kriteresh që kanë vërejtur studiuesit, e cila është krejtësisht e përligjur në rastin konkret. Në të vërtetë vlerat e kësaj përmbledhjeje folklorike nuk duhen parë në këtë aspekt, po në aspekte të tjera, kryesisht për njohjen e interesave intelektuale dhe të botës shpirtërore të Marksit të ri.
Kështu duhet vështruar dhe kënga popullore shqiptare që gjendet në album. Ajo mban titullin "Këngë shqiptare" dhe është shoqëruar me fjalët: "E bërë e njohur në shënimet e Lord Bajronit te "Shtegtimet e Çajld Haroldit", Shtegtimi 30-të". Pra, menjëherë duket qartë se nga është marrë. Besojmë se kjo këngë nuk është zgjedhur rastësisht nga Marksi por, së pari, sepse i ka pëlqyer dhe, së dyti, sepse është nxjerrë nga një burim serioz i garantuar, siç është poema e njohur e Bajronit.
S.S. Praueri në veprën e vet "Karl Marksi dhe letërsia botërore" na sjell një të dhënë me mjaft interes, kur duke shqyrtuar nga afër albumin folklorik vë në dukje, ndërmjet të tjerash, se "në një nga shënimet që i shoqëronin këto poezi, Marksi i shkruante Zhenit se ai ishte në këto vargje bashkë me të, njësoj si vargjet e krijuara prej tij, në një shoqëri poetike shumë të nderuar". "Një këngë me origjinë shqiptare, – shpjegonte ai, – figuronte në "Shtegtimet e Çajld Haroldit"."
Dihet se Bajroni në vjeshtën e vitit 1809 udhëtoi nëpër Shqipëri, provoi mikpritjen e Ali Pashë Tepelenës, njohu e çmoi shqiptarët dhe vendin e tyre të bukur. Nën këto përshtypje lindi dhe poema e Çajld Haroldit, të cilën filloi ta shkruante që në Janinë. Një këngë të tërë, të dytën ua kushtoi Shqipërisë dhe shqiptarëve. Dihet, gjithashtu, se gjatë udhëtimit poeti mbajti shumë shënime, mblodhi të dhëna të ndryshme, u shkroi letra nënës e miqve. Në to ne gjejmë mendime e konsiderata sidomos për vlerat e kulturës popullore shqiptare.
Veçanërisht në rastin tonë tërheq vëmendjen fakti se në këtë udhëtim Bajroni mblodhi në Shqipëri dhe në mjediset e arbëreshëve të Greqisë edhe folklor shqiptar. Sipas pohimit të poetit, marshi luftarak "Tamburxhi! Tamburxhi!", që këndohet në poemë, zu fill "nga këngë të ndryshme shqiptare" të mbledhura prej tij. Përveç këtij marshi, Bajroni mblodhi dhe botoi në shënimet e këngës së dytë të "Shtegtimeve të Çajld Haroldit" edhe "dy këngë popullore shqiptare".
Në shënimet ai shkruan se "si shembull të dialektit shqiptar ose arnaut të ilirishtes po jep këtu dy prej këngëve korale më popullore, të cilat këndohen zakonisht në valle nga burra e gra pa dallim …". Pastaj shton se "ato u kopjuan prej një njeriu i cili e flet dhe e kupton fare mirë këtë gjuhë dhe që është vendës nga Athina". Poeti e ka fjalën për shqiptarët Vasil Dangëllisi e Dervish Tahiri, të cilët e shoqëruan për 20 muaj nëpër Shqipëri, Greqi e Turqi dhe i dhanë mundësi të njihet sa më shumë me vlerat e kulturës popullore shqiptare.
Marksi, që e pëlqente në mënyrë të veçantë Bajronin, për frymën e revoltës dhe pakënaqësinë ndaj realitetit borgjez, jo vetëm e rilexonte poemën "Shtegtimet e Çajld Haroldit", po dhe diti të përfitonte dhe nga vlera të tjera, siç ishin shënimet e autorit që shoqëronin veprën. Prej tyre Marksi mori dhe këngën shqiptare. Ajo është nxjerrë nga "Vepra të përmbledhura" të Lord Bajronit, përkthyer në gjermanisht nga Adolf Botger dhe botuar në Lajpcig më 1839. Me sa shihet, botimi është fare i freskët, sepse po atë vit Marksi përgatit e i dhuron Zhenit albumin e tij.
"Kënga shqiptare" i përgjigjet frymës së përgjithshme të albumit, qoftë për faktin se ajo është këngë popullore e mirëfilltë, me karakter të theksuar lirik. Nëpërmjet monologut, poeti popullor tregon dëshirat e zjarrta që i ka zgjuar dashuria. Ajo është patetike, e furishme, pak liçencioze, po realiste, e natyrës rustike dhe ndofta për këto arsye dhe për sinqeritetin e çiltër i ka pëlqyer dhe djaloshit nga Triri.
"Kënga shqiptare" u botua nga Bajroni në origjinal, ashtu siç u dëgjua dhe u përkthye në anglisht prej tij. Por, siç dihet, varianti origjinal paraqet vështirësi kuptimi, prandaj dhe kemi disa variante transkriptimi.

**PO JAPIM VARIANTIN E BOTUAR NË REVISTËN "ALBANIA" TË F. KONICËS, QË NA DUKET PAKA SHUMË MË I QARTË:**

Në sevda tënde u llavosa (plagosa) / Vetëmë u përvëlofsha /Ah, vashëzë më përvëlove / Se më rend (zemrën) më llavose. / U (unë) të thashë, rrobe s'dua, / Siti (sytë) e vetullat e tua./ Rrobat stin orji (në djall të venë), s'i dua./ Kurmthin (trupin) vetë dua. /Kurmthin dua çë vëlon.
Rrobet zjarrmi t'i djeg./U (unë) t'agapiva (dashurova), vashëzë,/Ë me zemërën të haptë/Ë t'i m'u bëre e pabesë/Si një dhëndro të lartë.
"Kënga shqiptare" në gjermanisht, e rikthyer fjalë për fjalë në gjuhën shqipe paraqitet kësisoj:
Jam plagosur nga dashuria jote, dhe doja të plagosesha./Ti më bëre krej për vete, o vajzë në zemër më godite!/Të kam thënë se pajë tjetër s'dua,/Përveç syve dhe qerpikëve të tua!/Pajën e dëshiruar nuk ta kërkoj/ Dëshiroj vetëm syt' e tu,/Më jep hirin e bukurisë sate/Dhe dorëzoja atë pastaj flakëve!/Të kam dashur, o vajzë me shpirt t'pafajshëm,/Por ti më thave e më bëre dru./Po të vija dorën në gjoksin tënd, ç'do të fitoje?/E tërhoqa dorën, po flaka vazhdon të më djegë!
Siç shihet, varianti i ri në shqip i "Këngës shqiptare" jepet prej përkthimit nga origjinali në anglisht dhe nga anglishtja në gjermanisht. Ajo rikthehet kështu në gjuhën amtare nëpërmjet dy gjuhëve të huaja. Nga krahasimi i bërë ne mes origjinalit dhe përkthimit gjermanisht mund të vërejmë se në tërësi nuk ka ndryshime thelbësore. Është ruajtur brendia, mendimi poetik i këngës, figurat më të rëndësishme.
Megjithatë, kënga e rikënduar në anglisht nga një poet i madh si Bajroni dhe e përkthyer pastaj në gjermanisht ka ndryshuar, duke fituar vlera të reja shprehëse. Nga një anë, është bërë më i qartë mendimi e figurat kanë dalë më në reliev dhe, nga ana tjetër, këngës i janë shkurtuar dy vargje.
Sipas një shënimi të Bajronit, dy distikët e fundit, meqë janë në masë të ndryshme, duhet t'i përkasin një balade tjetër, po në "Këngën shqiptare" të përkthyer nuk ndihet ndryshimi i distikëve të tjerë me dy distikët e fundit. Kjo vjen ngase kënga ka një hero lirik të përbashkët, se fjalët e saj, si në rastin e parë dhe në të dytin i drejtohen vajzës nga djali i dashuruar. Ndryshimet e tjera kanë të bëjnë me disa figura fjalësh, si, në vend të vetullave është vënë qerpikë, në vend të kurmit është hiri i bukurisë e ndonjë tjetër.
Po kështu, vargjet me rimë të origjinalit, janë dhënë në gjuhë të huaj me vargje të bardhë. Megjithatë, pavarësisht nga këto ndryshime, "Kënga shqiptare" është ridhënë me bukurinë dhe thjeshtësinë e vet, ajo jep qartë momentin psikologjik dhe frymën lirike të origjinalit. S'ka dyshim se janë këto vlera që tërhoqën vëmendjen e Marksit të ri dhe e bënë "Këngën shqiptare" të jetë një nga këngët popullore të parapëlqyera prej tij.

**/Dita/**




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Maqastena: Paraqitje e mirë e gjimnastëve në Slloveni

"13 sportistët e Kosovës kanë bërë një paraqitje të mirë në Slloveni. Fituam përvojë të re dhe biseduam me zyrtarë të shteteve të ndryshme për bashkëpunim në fushën e gjimnastikës", ka thënë Shkumbin Maqastena, trajner i gjimnastikës

"Epoka e re"

PRISHTINË, 30 TETOR - Tetë gjimnaste dhe pesë gjimnastë e kanë prezantuar Kosovën në garat që janë mbajtur ditë më parë në Maribor të Sllovenisë. Një nga tre trajnerët e reprezentacionit të Kosovës, Shkumbin Maqastena, e ka vlerësuar pjesëmarrjen në këtë garë si pozitive për sportin e gjimnastikës, i cili është duke bërë hapat e parë në Evropë. "13 sportistët e Kosovës kanë bërë një paraqitje të mirë në Slloveni. Fituam përvojë të re dhe biseduam me zyrtarë të shteteve të ndryshme për bashkëpunim në fushën e gjimnastikës", ka thënë Maqastena. Trajneri në fjalë ka konfirmuar se Kosova ka marrë përkrahje nga Sllovenia dhe Kroacia për të marrë pjesë në kampet e përbashkëta stërvitore. Trajneri Maqastena ka bërë me dije se të gjithë ata që janë të përfshirë në sportin e gjimnastikës në Kosovë janë duke dhënë maksimumin që ky sport të zhvillohet dhe Kosova të përfaqësohet denjësisht në garat ndërkombëtare.



"Ne jemi në fillim dhe po përpiqemi shumë ta ngrehim vlerën e këtij sporti artistik në mënyrë që shtetin tonë ta forcojmë me vlera produktive. E falënderoj Federatën e Gjimnastikës së Kosovës e cila mbështeti këtë projekt si dhe të gjithë ata që ndihmuan garën, prindërit dhe dashamirët e sportit", ka shtuar Maqastena.

Rezultatet në këtë garë nuk janë pritur për shkak se Kosovës i mungon përvoja në gara të tilla. Kryetari i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, Besim Halilaj, ishte shprehur mjaft i lumtur se gjimnastët e Kosovës do ta kenë rastin të marrin pjesë në garat ndërkombëtare, por kishte paralajmëruar se nuk janë pritshmëritë e mëdha për rezultate. "Pjesëmarrja në këtë garë është diçka pozitive për gjimnastikën e Kosovës, pasi Federata e Gjimnastikës më në fund ka arritur ta mobilizojë një ekip solid për të marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare. Ne nuk presim rezultate shumë të larta për shkak se kemi filluar vonë të mobilizohemi", ka thënë Halilaj.

Gjimnastët e Përfaqësueses së Kosovës, të udhëhequr nga trajnerët Sherife Aliqkaj-Qerimi, Shkumbin Maqastena dhe zyrtari i kësaj Federate e trajneri Bujar Zatriqi, që e përfaqësuan Kosovën në Maribor të Sllovenisë janë: Bora Hoti, Vilëza Zeqiri, Valëza Rama, Altina Krasniqi, Regjina Shala, Elena Mangjolli, Diella Latifaj, Viera Gërguri, Elion Vitia, Elvis Çitaku, Ermal Hyseni, Dite Behluli dhe Alfredo Vincenzo.

# Vukiqeviqi largohet nga 'Nikli', zëvendësues Bunjaki ose Sokoli

Trajneri Dejan Vukiqeviq pas tre muajsh është larguar nga skuadra e Feronikelit pasi nuk arriti rezultatet e pritura në dymbëdhjetë xhirot e para. Në opsion për të zëvendësuar atë janë Albert Bunjaki dhe Bylbyl Sokoli

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 TETOR - Trajneri nga Mali i Zi, Dejan Vukiqeviq, është larguar edhe zyrtarisht nga skuadra e Feronikelit. Ndërprerja e bashkëpunimit me skuadrën e "Niklit" ishte pritur që disa javë, por vendimtare duket se ka qenë humbja ndaj Drenicës në Skenderaj (1-0). Vukiqeviqi është përshëndetur të mërkurën paradite me lojtarët e skuadrës së Feronikelit, kurse stërvitjen e ka drejtuar ndihmëstrajneri Ramiz Dervishi. Të mërkurën pasdite edhe skuadra nga Drenasi nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare të klubit njoftoi për largimin e



Vukiqeviqit. "Pas një bisede të trajnerit Dejan Vukiqeviq dhe presidentit të klubit, Naser Ramaj, që të dy janë pajtuar të ndërpritet bashkëpunimi, që do të thotë se Vukiqeviqi nuk do të jetë më trajner i FC Feronikelit. Është e dukshme që klubi po kalon në një fazë jo të mirë dhe se ndryshimet ishin të nevojshme, prandaj edhe erdhi deri te kjo ndërprerje e bashkëpunimit", thuhet në njoftimin e "Niklit".

Klubi kampion e falënderoi trajnerin Dejan Vukiqeviq për punën dhe profesionalizmin e treguar deri në ditën e tij të fundit si trajner i klubit, derisa bëri me dije se me kohë do të bëhet i ditur pasardhësi i trajnerit malazez. Vukiqeviqi tre muaj me parë ishte emëruar trajner i skuadrës së Feronikelit, derisa ishte edhe më i paguari në futbollin e Kosovës me 8 000 euro në muaj. Gazeta nga burime brenda Klubit të Feronikelit ka mësuar se pasardhës i teknikut malazez pritet të jetë ish-përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Albert Bunjaki, por në opsion, ashtu sikurse edhe herëve të tjera, është Bylbyl Sokoli. Skuadra nga Drenasi ndeshjen e radhës e zhvillon ndaj Ballkanit nga Suhareka, kurse aktualisht pozicionohet e gjashta në Superligë.

# Mabetex Prishtina, synime të mëdha ndaj Beshiktashit



PRISHTINË, 30 TETOR - Mabetex Prishtina të enjten do të përballet me skuadrën e njohur turke Beshiktash në kuadër të grupeve në FIBA EuroCup Women. Ky është takimi i tretë në grupe për këto dy skuadra, që kanë pësuar humbje në dy ndeshjet e para. Kjo është hera e parë që një skuadër nga Kosova po luan në këtë nivel garash dhe vashat prishtinase kanë nevojë për përkrahje nga tifozët. Hyrja është falas për këtë sfidë dhe tifozët do të kenë mundësi të shohin një ndeshje të bukur ndërmjet kampionit të Kosovës dhe skuadrës së njohur turke. Synimi i Mabetex Prishtinës është që të fitojë përvojë në këtë garë shumë të rëndësishme evropiane, derisa ndodhet në një grup shumë të vështirë, që ka buxhet shumë më të madh dhe përvojë më të madhe ndërkombëtare. Pjesë e këtij grupi janë Sparta&k M.R. Vidnoje dhe MBA Moscow, që do të përballen ndërmjet tyre. Ndeshja Mabetex Prishtina - Beshiktash do të zhvillohet të enjten nga ora 20:00.

## Prishtina, Drita dhe Drenica dënohen me nga 1 000 euro

PRISHTINË, 30 TETOR - Tri skuadrat e IPKO Superligës së Kosovës në futboll, Prishtina, Drita dhe Drenica, janë dënuar nga Komisioni Disiplinor me nga 1 000 euro. Skuadra kryeqytetase është dënuar për lëshimet që ka bërë në organizimin e ndeshjes Prishtina - Drita, e cila është zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri". Gjatë kësaj ndeshje janë hedhur mjete në fushë. Për ndeshjen e zhvilluar në kryeqytetet është dënuar edhe Drita si pasojë e sjelljes jo të duhur të shikuesve të saj të cilët kanë hedhur në fushë mjete piroteknike. Ndërsa skuadra kuqezi e Drenicës është dënuar për shkak të sjelljeve të tifozëve të tyre në ndeshjen ndaj Feronikelit. Tifozët e Drenicës në kor kanë bërë ofendime ndaj skuadrës mysafire.



## Federata e Futbollit të Zvicrës mbështet Xhakën



CYRIH, 30 TETOR - Federata e Futbollit e Zvicrës ka lëshuar një deklaratë lidhur me rastin e Granit Xhakës. E ardhmja e mesfushorit tek Arsenali mbetet e paqartë që prej zënkës që pati me tifozët në fundjavë. Futbollisti shqiptar i shau tifozët e "topçinjve" në "Emirates Stadium" pasi ata i fishkëllyen me rastin e zëvendësimit në ndeshjen kundër Crystal Palaces. Ndërkohë që trajneri Unai Emery ka dhënë disa deklarata në lidhje me situatën, nuk ka munguar edhe një deklaratë nga federata e vendit të cilin e përfaqëson futbollisti. "Jemi në kontakt me Granitin. Ne i vlerësojmë cilësitë e tij dhe rëndësinë që e shfaq për ekipin tonë përfaqësues. Si rezultat i kësaj, pozita e tij nuk do të ndryshojë", thuhet në njoftim, citon "The Mirror". Në ndërkohë, trajneri i Arsenalit nuk e ka sqaruar nëse do t'i merret 27-vjeçarit shiriti i kapitenit.

# Rama, djali i luftës në futboll



MEPPEN, 30 TETOR - Valdet Rama është rikthyer në Gjermani dhe e ka rinisur aventurën e re në mënyrën e duhur pas atij largimi nga Kukësi, duke përshëndetur rrjetën dhe duke bërë detyrën që di më mirë, të shënojë gola në portën kundërshtare. Ndërkohë në Gjermani i janë kthyer pak të kaluarës së Valdet Ramës. Pikërisht njeriut që u largua nga Kosova bashkë me familjen, për shkak të luftës, duke shkuar në Gjermani. Sulmuesi që luan me Meppen do të përballet këtë javë ndaj BSV Rehdenit, atje ku do të takohet me trajnerin Heiner Backhaus. Një person shumë i veçantë në jetën e Ramës, pasi do të ishte Backhaus që do t'i jepte ndihmën e parë në futboll. "I jepte shumë gojës. Gjithashtu, më sfidoi të luaja më të, duke më thënë: 'Ti je futbollist profesionist? Luaj me mua. U lodha shumë me të, ishte edhe shkurtabiq. Tani ne jemi shumë miq dhe Rama më uron i pari datëlindjen'", ka thënë trajneri Backhaus. Ndërkohë cilësitë e "shkurtabiqit" nuk kanë kaluar pa u vënë re edhe nga një mik i teknikut gjerman. "Çfarë po bëhet me këtë djalin, qenka super lojtar?" Tashmë Rama do të përballet me të kaluarën e vet, për t'iu kujtuar gjithçka që nga koha kur e nisi karrierën.

# Lakersat triumfojnë ndaj Memphisit, Denveri pëson humbjen e parë



LOS ANGELES, 30 TETOR - Los Angeles Lakersi e ka tashmë thjesht një kujtim të hidhur me humbjen në ndeshjen e parë të sezonit të rregullt ndaj Los Angeles Clippersit. Të udhëhequr nga dyshja James-Davis, kalifornianët morën fitoren e tretë radhazi përballë Memphis Grizzliesit, që mundën të rezistonin vetëm në pjesën e parë, për t'u dorëzuar më pas pa kushte për rezultatin përfundimtar 120-91. I papërmbajtshëm Andhtony Davis me 40 pikë dhe 20 "rebounde", ndërsa "Mbreti" James u kënaq me vetëm 23 pikë dhe 8 asistime. Në radhët e skuadrës nga Tennessee shënuesi më i mirë rezultoi Morant me 16 pikë. 16 herë kampionët e NBA-s renditen të tretët në Perëndim me 3 fitore dhe 1 humbje, ndërsa me Grizliesin ndodh e kundërta, pasi kanë koleksionuar 1 fitore dhe 3 humbje. Vjen humbja e parë sezonale për Denver Nuggetsin pas tri sukseseve radhazi. Ua shkaktoi Dallas Mavericksi me rezultatin 106-109, duke nxjerrë në pah problemet që ishin shënuar edhe më parë, por që fitoren e fillimsezonit i kishin fshehur. Skuadra nga Colorado dominon sa iu përket pikëve të shënuara nga 5-shja titullare (84/50), por disfata është neto kur bëhet fjalë për pikët e lojtarëve të stolit. Kjo dallohet qartë edhe te statistikat, ku 4 pikëshënuesit më të mirë të sfidës janë të Denverit, me më të mirin Millsap me 23 pikë. Atlanta Hawksit nuk i mjaftoi Jonh Collinsi, që rezultoi më i miri mbi parket me 30 pikë, pasi u mposht 112-97 nga Miami Heat. Për skuadrën nga Florida spikati Tylor Herro me 29 pikë, ndërsa Goran Dragiq shtoi edhe 21 pikë të tjera.

## SHKURT

### Mourinho, afër rikthimit në Premierë Ligë

Trajneri Jose Mourinho mund të rikthehet në Premierë Ligë. Ky është lajmi i bujshëm që ka nisur të përsëritet shpesh në mediet angleze dhe jo vetëm. Së fundmi, në emisionin e njohur "El Chiringuito", një prej gazetarëve deklaroi se po e mendon seriozisht një rikthim në Premierë Ligë, konkretisht për ta marrë drejtimin e Arsenalit. Sipas gazetarit Diego Plaza, Mourinho e sheh me sy të mirë një rikthim në Angli dhe do t'i pëlqente ta merrte drejtimin e Arsenalit, që do të bëhej klubi i tretë i ndryshëm që drejtohej në ishull nga luzitani. Stoli i Emeryt po lëkundet tashmë, ndoshta Mourinho mund të rikthehet në aksion.

### Hazard: Kam ardhur në Real për Ligë të Kampionëve

Eden Hazard iu bashkua Real Madridit nga Chelsea verën e kaluar për një tarifë që u raportua të jetë prej 100 milionë eurove. Belgu ka fituar dy tituj në Premierë Ligë dhe dy trofe të Evropa Ligës gjatë kohës së tij në Londër, por i ka munguar medalja si një fitues i Ligës së Kampionëve. "Ashtu siç e kam thënë në ditën time të parë, për mua Liga e Kampionëve është e rëndësishme. Në Londër unë kam arritur vetëm në gjysmëfinale. Chelsea ka fituar të vetmin trofe në Ligë të Kampionëve një vit para se t'i bashkohem asaj", ka thënë Hazardi. "Këtu e kanë fituar shumë herë gjatë viteve të mëparshme dhe është vështirë për të fituar këtë çdo sezon sepse janë shumë skuadra të përfshira, por unë kam ardhur këtu për ta fituar këtë sepse është e rëndësishme për të gjithë dhe kështu është edhe për mua", ka shtuar Hazardi.

### Duranti planifikon të pensionohet në Evropë

Kevin Durant, ylli i NBA-së, aktualisht pjesë e skuadrës së Brooklyn Netsit, në një intervistë për "Bleacher Report" ka deklaruar se dëshiron që sezonin e fundit të karrierës së tij të luajë në Evropë. Më saktë, ai dëshiron të luajë në Euroleague, duke treguar edhe skuadrën e vet të preferuar, Barcelonën.

### Reali heq dorë nga transferimi i Pogbas

Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, nuk dëshiron t'i vazhdojë bisedimet me Manchester Unitedin për mesfushorin Paul Pogba. Pavarësisht që Pogba kërkohet nga Zinedine Zidane, Perezi ka refuzuar të paguajë një shumë të madhe parash për futbollistin francez. Unitedi nuk dëshiron ta shesë lojtarin nëse nuk paguhet prej 170 deri në 200 milionë euro, vlerë e cila është shumë e lartë për gjigantin spanjoll.

### Guardiola: Xavi do të bëhet trajner i Barçës

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, beson se legjenda katalunase do të bëhet në të ardhmen trajner i Barcelonës. Xavi është i lidhur me stolin e klubit blaugranas në vend të Ernesto Valverde edhe pse për momentin është trajner i Al Saddit. "Xavi ishte trajner kur luante, sytë e tij shkëlqenin kur shikonte futboll. Do të bëhet trajner i sigurt. Janë lojtarë që kanë luajtur mirë dhe mund të thuash se asnjëherë nuk do të bëhen trajnerë, por ai nuk i përket kësaj çështje. Së shpejti ose më vonë do të arrijë në Barcelonë", ka thënë Guardiola.

**Autor: GAZMEND MORINA**

ISH KITARISTI ANGLEZ NË FOTO 1

ZONË E PËRHAPJES NATYRORE TË NJË GRUPI BIMËSH A KAFSHËSH

AKTORI AMERIKAN ... DAMON (shqip.)

KËNGËTARI .... POSHKA

AKTORI QOSJA

BIMË E VISEVE TROPIKALE

NANTES

EPOKA E RE

ORGANIZATË EKSTREMISTE NË PALESTINË (shq.)

KYÇ

VLERA E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT

SËMUNDJA E TOKËS, EPILEPSIA



1

VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU, SI JELEK ME GAJTANË

NJË E HAPUR E NJËRËS KËMBË PARA OSE PRAPA (shq.) / LAPSI

SHTET FEDERAL NË SHBA

HENDEK I THELLË E I GJERË, QË ËSHTË HAP-UR PËR TË UJITUR

RRJETËZA E SYRIT

ALYSA MILANO / AKTORI PRAPASHTICA (shq.)

NOTË MUZIKORE / BASHKËTING.

XHAMAJKA, ARMENIA

BANORËT E KRYEQYTETIT TË FILIPINEVE / KËNGËTARJA & MODELJA DRENUSHA

“H” para dy “L”

FILOZOF GREK / AKTORJA HUDSON (origj.)

TAJVANI, INDONEZIA / MOTRAT E NËNËS

ZANORE

ADRIAN KRASNIQI / SHTET NË AZI

LLOJ BUKE / VIGANI, KOLOSI

ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË

RRETH QË RROTULLOH-ET PËR TË VËNË NË LËVIZJE NJË MJET (sh.shq.)

“RISANI” / KËNGËTARJA BUNJAKU

ORGANIZATË SEPARATISTE NË SPANJË / FRIKACAKET, IKATARET

Që shfaqet si mbeturinë e trashëguar nga tiparet e paraardhësve të lashtë

MËDYSHJET

ONTARIO

EPOKA E RE

VEPËR E KRIMINELIT

BËRJA SI TJETRI

INDIA, ZAIRI / SULFUR, NEON

GRUA QË USHQEN ME GJI FËMIJËN E DIKUJT TJETËR / LEZHA

BASHKËTING. / DEGË E MATEMATIKËS

AKTORJA RUGOVA / TONELATA

TËRËSIA E ESHTRAVE TË TRUPIT TË NJERIUT / SHTET (Fr.)

DY BASHKË-TINGËLLORE

VEND LUFTIMI I GLADIATOR-ËVE (sh.shq.) / PLAK QË MERREJ SI GJYQTAR

RICHMOND ANIMAL LEAGUE / ISH TRAJNERI I BOKSIT LAH ......

ROTHERHAM, IPSVICH / SHKRONJA XVI

NORA ISTREFI

BASHKIM I FORTË DHE I PANDASHËM / TOPI JASHTË LOJE

RRAFSHIM, BARAZIM LARTËSISH / NAIM ISMAJLI

EPOKA E RE

KAMPIONI

MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAI / KALIUM, ALUMIN

KRIJIM I NJË FILMI TË VIZATUAR / QYTET NË SHQIPËRI

BASHKËTING. / DRU I GJATË

MUAJ I VITIT

QË DO ZGJIDHJE SHUMË TË SHPEJTË

ZBRITJE E AEROPLANIT NË TOKË / NIKEL

SHKOJ NËPËR DIÇKA OSE PRANË DIÇKAJE

DJALL, LANET (hebr.)

IRNOSE (bised.) / KËNGËTARJA NË FOTO 2 MILIAN

ZANORE KUNDËRSH-TARI I PËRBETUAR

SHKRONJA GREKE

KËNGËTARJA TARNER / OBJEKTI I BISEDËS

QË U PËRKET PARAARDHË-SVE TANË

KASOLLE E BARINJVE (sh.shq.) / SENDE QË ÇMOHEN PËR VJETËRSI

“SONATA” / TATIMI

2



RADIUM, ELEKTRON / KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE

RITUALET

MARK ANTONI / SHKRONJA XXVIII

BASHKËTING. / LLOJ AGRUME

AMATOR, DILETANT (krah.) / BOKSIERI .... SEFERI

DIKTATOR SOVJETIK

ALFRED KAÇNARI / BASHKËTING.

TEPELENA / KËNGËTARI RAMAZZOTTI

GURRË, BURIM UJI (sh.shq.)

TITAN

ARRATISUR NGA BURGU / PËREMËR VETOR

BITUMI NATYROR / KOD I TELEFONIT MOBIL

I PASUR, PASANIK

KRITER / MIMOZA AHMETI

PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË

PËREMËR PRONOR / ZANORE

“O” para dy “A” / ZANORE

ANDORA

VENDI KU LIDHEN ESHTRAT

VENDËS, RRËNJËS

TROYES

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: XHAMADAN, HAPI, OREGON, KANAL, RETINA, AM, RE, XHA, MANILASIT, HLL, TALES, TI, A, AK, SIMITE, RROTAT, RI, ETA, IMITIMI, IZ, DADO, K, SAFETE, SKELETI, TR, TONI, ARENAT, RAL, RI, NI, UNITET, NIVELIM, ARITA, ANIMIM, G, AKUT, ATERIM, KALOJ, SATAN, IRE, A, TINA, ILIRIK, STANET, SON, RAE, RITET, MA, PINK, M, AMATER, STALIN, AK, T, TI, IKUR, SERA, I KAMUR, PARIM, NATO, IMI, OAA, A, ANI, ANAS, T.

**Kërkesa për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: **"Rexhep Akllapi"Akllap**

Komuna: **Lipjan**

Data: **31.11.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/048-CS/1.2** | **Trajnimi për Gjithëpërfshirje** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shkolles "Rexhep Akllapi"Akllap,Lipjan.** Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollësNë kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Primljeno: 30-10-19
Njësia/Jedinica: 4-153 Numri/Broj: 70816 Shtojca/Dodatak

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë. Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha Gjitheperfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme Gjitheperfshirje (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **SHFMU"Rexhep Akllapi"Akllap,Lipjan më së largu deri më 08.11.2019.**Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues: Flamur Gashi**

**Telefoni: 044/375-389**

**E-maili:fl.gashi@hotmail.com**

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "BIG BUSINESS INVESTMENT GROUP" SH.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NURB. Biznesit 810067117 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "BIG BUSINESS INVESTMENT GROUP" L.L.C, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NURB. Biznesit: 810067117 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "BIG BUSINESS INVESTMENT GROUP" L.L.C, has come to the decision to quit its business: NURB. Biznesit: 810067117 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Kërkesa për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: **"Migjeni"Rufc i Ri**

Komuna: **Lipjan**

Data: **31.11.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/047-ESIP/SDG/047-CS/1.2** | **Trajnimi për Gjithëpërfshirje** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shkolles "Migjeni"Rufc i Ri Lipjan.** Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollësNë kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkolles
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Pranuar më: 30-10 2019
Njësia/Jedinica: 4-153 Numri/Broj: 70814 Shtojca/Dodatak

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë. Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha Gjitheperfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme Gjitheperfshirje (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **SHFMU"Migjeni"Rufc i Ri,Lipjan më së largu deri më 08.11.2019.**Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues: Metush Jashanica**

**Telefoni: 044/812-462**

**E-maili:metush.jashanica@universitetiaab.com**

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "OIL DISTRIBUTION" SH.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NUI. 8100842494 dhe me NRB: 71100510 dhe nr. fis. 601170591, ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "OIL DISTRIBUTION" D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa : NUI 8100842494 i sabrojem NRB: 71100510 i fis: 601170591 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "OIL DISTRIBUTION" L.L.C, has come to the decision to quit its business: NUI. 8100842494 the NRB: 71100510 nr. fis. 601170591 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "ECO – KOS" L.L.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aktivitetin e grumbullimit të mbledhjes dhe eksportit të vajrave ushqimor në rrugën Milloshevë-Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.11. 2019 në ora 10:00 në hapësirat e zyrës së kompanisë "ECO – KOS" L.L.C. në rrugën e Llapit, Milloshevë komuna e Obiliqit do të organizohet debat publik nga kompania "ECO – KOS" L.L.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aktivitetin e grumbullimit të mbledhjes dhe eksportit të vajrave ushqimor në rrugën Milloshevë-Obiliq.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.







## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ V.I.P. "NESA" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 70883996

▶ Kadir Bajra shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Leke Dukagjini" Prizren

▶Lule Qenaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶Bekim Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Ibrahim Fehmiu" Arbane

▶Kadri Durco shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Rrezarta Bobaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Dy Dëshmorët " Korishe

▶ Selatin Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Naim Memaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Naim Frasheri" Vlashnje

▶ Ardian Kastrati shpall të pavlefshme Vendimin Origjinal të Nostrifikimit të Doktoraturës të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.


Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense
Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs
Human Resources Directorate
KONKURS
PËR REKRUTIMIN E KADETËVE PËR SHKOLLIM NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE
DHE AKADEMINË USHTARAKE –WEST POINT TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
Afati i konkurimit:
Konkursi është i hapur prej 22.10.2019 deri më 04.11.2019.
Ministria e Mbrojtjes iu shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës
dhe mirëpret aplikacionet e të gjithë kandidatëve të interesuar
pa dallim gjinie, race dhe përkatësie etnike.
Konkursi dhe formularët për aplikim janë në dispozicion në Komandën e Forcave Tokësore
dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, www. mod.rks-gov.net.
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-355.